



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional në:

“Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve ”

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Anila Hoda

Prof.Dr. Mirela Lika (Çekani)

Shtator / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
me karakter profesional në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”

1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Agronomisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 373, datë 05.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 80, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 (pestë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023 -- 21 studentë; Viti akademik 2023-2024 -- 17 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Korçës u krijua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.5, datë.07.01.1992. Në vitin 1994 atij iu dha emri Universiteti “Fan S. Noli”, universiteti u çel mbi bazën e institutit të lartë bujqësor dhe të filialit të Universitetit të Tiranës me degë të tilla si inxhinieria, ekonomiku e mësuesia. Aktualisht, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë përbëhet nga 4 fakultete:

1. Fakulteti i Bujqësisë;
2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë;
3. Fakulteti i Ekonomisë;
4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane;

Programi i studimit me karakter profesional në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është licensuar sipas Urdhërit të MASR Nr. 373, datë 05.07.2018. Ky program studimi ka kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike me kohë të plotë (4 semestra) në përfundim me sukses të së cilit studenti fiton 120 kredite. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë profesionale në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi ofrohet pranë Departamentit të Agronomisë, Fakulteti i Bujqësisë.

Programi synon të përgatisë specialistë të kualifikuar për të mbështetur dhe zhvilluar më tej bujqësinë shqiptare. Aktualisht, programi ka një përvojë të konsoliduar dhe ka treguar sukses dhe interes të konsiderueshëm nga studentët. Programi ofron një kurrikul të përshtatur që i përgjigjet nevojave të tregut dhe përfshin njohuri të avancuara për teknologjitë e zbatuara në prodhimin e farave dhe fidanëve në fusha të ndryshme të bujqësisë si bimët e arave, pemëtari, vreshtari, perimtari dhe luletari.

Nga të dhënat e siguruar nga institucioni aplikant për këtë procedurë vlerësimi rezultojnë vijueshmëria konstante e programit të studimit me karakter profesional “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”. Rezulton se studentët e regjistruar në këtë program studimi në vitet e fundit akademike janë si më poshtë vijon:

Viti akademik 2022-2023 -- 21 studentë;

Viti akademik 2023-2024 -- 17 studentë;

Në përgjithësi, programi ka pika të forta në kurrikulën e përshtatur me nevojat e tregut, kompetencat e larta të stafit akademik dhe infrastrukturën e avancuar didaktike.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017, “Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Diplomë Profesionale në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, për programin e studimit me karakter profesional në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof.Dr. Anila Hoda** dhe **Prof.Dr. Mirela Lika**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoresha teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

GVJ shfrytëzoi RVB dhe një numër të konsiderueshëm evidencash, të cilat iu vunë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikën, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i Departamentit. GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm, autoritete drejtuese, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor dhe aktiviteteve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambjentet e brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin e studimit 2-vjeçar” në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”. GVJ vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën etj. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet e mëposhtme:

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.07.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 93/23 Prot, datë 30.07.2024. Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, njofton nëpërmjet shkresës me Nr. 1779/1, Prot, datë 31.07.2024,” *Dërgohen komente për draft raportin e vlerësimit të jashtëm*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i arsimit të lartë, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, (UniKo), e ka përmbushur kriterin e kërkuar për të ofruar programe studimi që janë në përputhje me interesat kombëtare dhe që synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Si pjesë e prioritetëve të qeverisë dhe Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Shqipërisë, bujqësia është një fushë kyçe, dhe UNIKO e përfshin këtë sektor si një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së tij, duke e përfshirë në misionin e universitetit dhe në Planin Strategjik 2022-2027 (Shtojca 1.1, Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”; Shtojca 1.3, Planin Strategjik i UNIKO 2022–2027). Programi dyvjeçar profesional në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” është një shembull i përpjekjes së UniKo për të ofruar arsim cilësor në fushën e bujqësisë. Rregullorja e programit tregon përmbajtjen e tij, e cila është përshtatur me nevojat e tregut dhe përmban njohuri të avancuara për teknologjitë e zbatuara në pemëtar, vreshtari, perimtar dhe bimët e arave (Shtojca 2.5, Rregullorja e programit të studimit: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”). Bujqësia, duke qenë sektori më i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare, që punëson një pjesë të madhe të fuqisë punëtore, është një fushë ku UniKo kontribuon në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. Kjo përputhshmëri me nevojat kombëtare është në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (2022-2024) (https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf; http://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/bujq%C3%ABsia/#tab1). Dekani ka shprehur

	mendimin pozitiv mbi akreditimin e programit të studimit, duke nënvizuar rëndësinë e tij dhe përpjekjet për të ruajtur vlerat akademike e kulturore kombëtare (Shtojca 3.1, Mendimi i dekanit për programin e studimit: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”). Në përfundim, UNIKO ka demonstruar përputhshmërinë e programeve të tij të studimit me interesat kombëtare dhe ka synuar ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare përmes përfshirjes së bujqësisë në veprimtarinë e tij arsimore dhe strategjike.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UniKo, ka hartuar dhe ofruar programe studimi në përputhje me qëllimet dhe misionin e tij, si dhe fushën e veprimtarisë. Misioni kryesor i UniKo-s është të krijojë, transmetojë, zhvillojë dhe mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, me synimin për të përgatitur specialistë të lartë dhe shkencëtarë të rinj, të formojë individë kompetentë dhe qytetarë të përgjegjshëm, të zhvillojë programe studimi dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve rajonale, dhe të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë (Shtojca 1.1, Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"; Shtojca 1.3, Plani Strategjik i UNIKO 2022–2027). Programi i studimit "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është një shembull i qartë i kësaj përputhshmërie, duke synuar përgatitjen profesionale të specialistëve në bujqësi në përputhje me kërkesat e tregut dhe zhvillimet teknologjike (Shtojca 2.5, Rregullorja e programit të studimit: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”).
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	UniKo, ka hartuar dhe ofruar programin e studimit profesional dyvjeçar në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" duke ruajtur vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, si dhe në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit, si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij. Ky program është në përputhje të drejtpërdrejtë me misionin e UNIKO-s (Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"), (Shtojca 2.5 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë) dhe (Shtojca 1.3 Plani Strategjik 2022–2027 të UNIKO). Këto garantojnë që programi jo vetëm të ndihmojë në zhvillimin profesional të specialistëve në bujqësi, por gjithashtu të mbështesë strategjinë e përgjithshme të zhvillimit dhe objektivat akademike të institucionit.

Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.

UNIKO, ka zhvilluar programin e studimit profesional dyvjeçar në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" bazuar në një analizë të detajuar të tregut lokal dhe kombëtar të punësimit, duke mbushur një boshllëk të rëndësishëm (Shtojca 2.5, Rregullorja e programit të studimit: "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve"). IAL e ka përshtatur vazhdimisht këtë program për të përmbushur nevojat e tregut, duke ofruar njohuri të avancuara dhe aftësi praktike në teknologjitë e prodhimit të farave dhe fidanëve për një gamë të gjerë kulturash bujqësore (Shtojca 1.1, Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"; Shtojca 1.3, Plani Strategjik i UNIKO 2022–2027). Programi synon të formojë specialistë të aftë, në përputhje me misionin e Fakultetit të Bujqësisë, për të përmbushur kërkesat rajonale dhe kombëtare të tregut të punës. Duke ndjekur këto të dhëna dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, UniKo ka hartuar një program që jo vetëm plotëson kërkesat e tregut, por edhe mbështet zhvillimin profesional të specialistëve të ardhshëm në bujqësi.

Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Programi i studimit me karakter profesional në: "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve", ofrohet nga Fakulteti i Bujqësisë i cili përbëhet nga 3 (tre) departamente:

1. Departamenti i Agrobiznesit;
2. Departamenti i Agronomisë;
3. Departamenti i Agroushqimit;

Fakulteti i Bujqësisë për vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar gjithsej 21 staf akademik, të gjithë janë staf akademik efektiv (PAE) me kualifikim si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Bujqësisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-
Prof.Asoc	8	-
Dr/PhD	8	-
Msc	4	-
Gjithsej	21	0

Në Departamentin e Agronomisë, i cili është përgjegjës për programin e studimit, po në këtë vit akademik rezulton staf akademik me kualifikim si më poshtë:

	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Agronomisë	
		PAE	PAK
	Prof.Dr	1	-
	Prof.Asoc	3	-
	Dr/PhD	2	-
	Msc	1	-
	Gjithsej	7	0
	Gjykojmë që institucioni në rang institucional por edhe njësie kryesore / bazë, ka kapacitete të plota në fushën e burimeve njerëzore dhe akademike për ofrimin e këtij programi studimi. ANEKS TABELAT PËRMBLEDHËSE		
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit me karakter profesional në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” ofrohet nga Fakulteti i Bujqësisë, Departamenti i Agronomisë. Gjykojmë që ky program studimi në përgjithësi dhe në mënyrë specifike në përmbajtje është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë të sipërpërmendura. Ky program është klasifikuar dhe kodifikuar në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane, duke u bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), e cila është harmonizuar me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të siguruar krahasueshmëri dhe njohje ndërkombëtare të diplomave shqiptare (Shtojca 1.1, Korniza Shqiptare e Kualifikimeve). Programi ka kodin: 52PP0811S dhe synon të ofrojë një arsim cilësor në fushën e bujqësisë, veçanërisht në prodhimin e farave dhe fidanëve të kulturave bujqësore, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UniKo (Shtojca 1.3, Strategjia e Zhvillimit të UNIKO 2022-2027). Bazuar në rregulloreën e programit synohet përgatitja e specialistëve në këtë fushë për ta bërë sektorin e bujqësisë konkurrues me bujqësinë e vendeve të rajonit. (Shtojca 2.5, Rregullorja e programit të studimit: "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve").		
Konkluzione	<i>Programi i studimit reflekton përputhjen me interesat kombëtare, synimin e universitetit për të përgatitur specialistë të lartë në bujqësi, si dhe hartimin dhe zhvillimin</i>		

	<i>e tij në përputhje me misionin dhe strategjinë e institucionit.</i> <i>Analiza e tregut lokal dhe kombëtar të punësimit është bërë për të adresuar nevojat aktuale dhe për të siguruar që programi të përmbushë kërkesat e tregut.</i> <i>UniKo ka demonstruar përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program, dhe fusha e studimit është në përputhje me klasifikimet dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UniKo ka krijuar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, duke ndarë detyrat mes njësive dhe personelit, marrë përgjegjësiwe përkatëse dhe analizuar vazhdimisht punën e tyre. Ky proces është realizuar përmes Planit Strategjik të Zhvillimit, i cili përfshin të gjithë anëtarët e komunitetit universitar, nga stafi mësimor dhe administrativ deri te studentët, të cilët janë të përkushtuar për të shpalosur mundësiwe e tyre në auditorë, laboratorë, biblioteka dhe konferenca shkencore (Shtojca 1.1 , Plani Strategjik i Zhvillimit).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimet në Institucion, vlerëson se UniKo ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, të cilat përfshijnë dhe realizimin e objektivave të procesit mësimor formues të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional. UniKo ka nënshkruar 12 marrëveshje ndërkombëtare dhe 12 kombëtare vetëm gjatë një viti, me universitete dhe institucione homologe si Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Prishtinës dhe shumë të tjerë (Shtojca 2.1 , Lista e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe

	Kombëtare). GVJ e konsidiron si praktikë të mire shfrytëzimin e përvojës pozitive në bashkëpunimin me universitetet ndërkombëtare për të zhvilluar projekte të përbashkëta dhe për të rritur mundësitë për studentët për shkëmbime ndërkombëtare.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	Institucioni garanton marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm lokalë dhe kombëtarë për realizimin e objektivave të procesit mësimor. Konkreisht janë të qëndrueshme 12 marrëveshje bashkëpunimi të realizuara për studentët e programit të studimeve profesionale "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve". Këto marrëveshje janë realizuar me institucione të ndryshme ku mund të përmendim, marrëveshjet me Qarkun Korçë, Bashkitë lokale të cilat sigurojnë që studentët e programit të kenë mundësi praktike të mësojnë teknologjitë e përdorura në prodhimin e farave dhe fidanëve (Shtojca 3.1, Lista e Marrëveshjeve me Institucionet dhe Kompanitë). Bashkëpunimi me shumë institucione dhe kompani private për realizimin e praktikave profesionale, duke siguruar një eksperiencë të vlefshme për studentët, GVJ e konsideron si praktikë të mire.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Fakulteti i Bujqësisë në UniKo ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private për realizimin e praktikave profesionale, ku studentët njihen nga afër me teknologjitë e avancuara në bujqësi (Takimi me studentët). Raportet analitike të përfitimeve nga këto marrëveshje hartohen periodikisht nga Departamenti i Agronomisë, duke evidentuar shkëmbimet e përvojave dhe aplikimet në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare (Shtojca 4.1, Raportet Analitike të Përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit). Këto raporte ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit të praktikave dhe në përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit (Shtojca 4.2, Marrëveshjet e Bashkëpunimit dhe Praktikat Profesionale).
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	UniKo ndërmerr iniciativa specifike për të mbështetur sipërmarrjen dhe punësimin e studentëve të programit dyvjeçar në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve". Në përfundim të këtij programi, studentët fitojnë njohuri dhe aftësi që i përgatitin ata të jenë teknikë të kualifikuar në prodhimin e farave dhe fidanëve duke përdorur teknologji bujqësore bashkëkohore (Shtojca 5.1, Programi i Studimit).

	Ata mësojnë të njohin tiparet karakteristike të rajonit dhe të ofrojnë produkte të cilësisë së lartë për fermerët, si dhe të përballen me sfidat e drejtimit të fermave bujqësore. Programi, gjithashtu, i inkurajon studentët të gjenerojnë ide për krijimin e fermave model për prodhimin e bimëve të arave, farishteve të perimeve dhe fidanishteve të pemëve frutore dhe luleve (Shtojca 5.2, Kurrikula e Programit). Pas përfundimit të programit, studentët mund të punësohen si teknikë dhe punonjës në ndërmarrjet e gjelbërimit të bashkive dhe njësive administrative, si teknikë të lartë pranë QTTB-ve, si sipërmarrës privatë në prodhimin e farave dhe fidanëve, apo në kompani private që operojnë në këtë fushë (Shtojca 5.3, Mundësitë e Punësimit për Absolventët).			
Konkluzione	<i>UniKo ka krijuar marrëdhënie të frytshme brenda institucionit për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse. Ndërkaq, në aspektin e bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe kompani të fushës, UniKo ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh, duke krijuar mundësi të shkëmbimeve të stafit dhe studentëve, si dhe aplikime në projekte ndërkombëtare.</i> <i>Për realizimin e praktikave profesionale, institucioni ka nënshkruar marrëveshje afatgjata me institucione dhe kompani përkatëse për të siguruar përvojë praktike për studentët.</i> <i>Raportet analitike periodike janë hartuar për të vlerësuar përfitimet nga këto marrëveshje dhe për të përmirësuar programin e studimit.</i> <i>Uniko ka ndërmarrë iniciativa specifike për të mbështetur sipërmarrjen dhe punësimin e studentëve të programit të studimit në bujqësi.</i> <i>Në bazë të gjetjeve, GVJ, konkludon se UniKo përmbush plotësisht standardin për bashkëpunimin në realizimin e programit të studimit në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se UniKo ka struktura dhe procedura specifike për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje dhe zbatim me parashikimet ligjore, nënligjore në fuqi si dhe aktet rregullatore të brendshme të miratuar me Vendim të Senatit Akademik. Këto struktura monitorojnë dhe vlerësojnë rregullisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore, duke synuar përmirësimin e cilësisë përmes sistemit të vetëvlerësimit dhe akreditimit, duke respektuar autonominë e universitetit. Përfshirja e studentëve në këtë proces është thelbësore, dhe ata kanë përfaqësimin e tyre në Senatin Akademik, komisionin e vlerësimit dhe Këshillin e Etikës (Shtojca 1.1, Statuti i Universitetit).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në kreun IX, nenet 84, 85 të Statutit të UniKo përcaktohet qartë se si hartohen dhe zbatohen procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Referaur nenit 84 Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, ku brenda këtij sektori funksionon dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila përfshin përfaqësues nga çdo njësi kryesore dhe organizimet studentore. (Shtojca 1.1 Statuti i UK) Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, planifikon organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Kjo njësi kryen studime për të vlerësuar efikasitetin e programeve dhe punësimin e studentëve, në bazë të Rregullores së Fakultetit të Bujqësisë (Shtojca 2.1, Plan Strategjik).
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon anketime periodike të studentëve për cilësinë e mësimdhënies (Takimi me studentët). Të dhënat e mbledhura përdoren për raportet e vlerësimit të brendshëm, të cilat më pas i dorëzohen komisioneve për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të saj. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitorojnë dhe vlerësojnë vazhdimisht veprimtaritë mësimore dhe kërkimore, duke hartuar raporte vjetore për performancën dhe rekomandime për përmirësim (Shtojca 3.1, Raporti i Vlerësimit të

cilësinë.	Brendshëm).			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	UniKo përdor tregues të qartë dhe të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit, dhe analizon rregullisht gjendjen, arritjet dhe dobësitë. Të dhënat e mbledhura përdoren për promovimin e arritjeve më të mira dhe për përmirësimin e programeve të studimit. Staf i akademik dhe administrativ luajnë një rol kyç në zbatimin e këtyre procedurave përmes bashkëpunimit me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Bazuar në të dhënat e raportit të vlerësimit, bëhen rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe sigurohet zbatimi i tyre (Shtojca 4.1, Analiza e Ecurisë së Programit).			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC) në përputhje me ligjin dhe aktet rregullatore institucionale, duke përfshirë studentët në procesin e sigurimit të cilësisë.</i> <i>UniKo ka një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.</i> <i>Përdorimi i instrumenteve dhe treguesve të duhur për sigurimin e cilësisë, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarive mësimore dhe kërkimore, janë praktika që ndihmojnë në përmirësimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Struktura dhe përmbajtja e programit me karakter profesional “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” është në përputhje me ligjin nr. 80/2015, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Programi është organizuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Programi ka në total 120 kredite (ECTS), është me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me kohë zgjatje 2 vite akademike, i shtirë në 4 semestra, me kohëzgjatje 15 javë mësimore çdo semester. Programi është i organizuar në lëndë/ module, i vlerësuar në kredite. Përfitimi i njohurive realizohen me anë të 26 lëndëve të shtrira në dy vite akademike:
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale, jep njohuri të specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Programi i studimit “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” ka informacione të detajuara për objektivat dhe veprimtarinë formuese me qëllim punësimin e studentëve. Programi i studimit me karakter profesional “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” është organizuar referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në <i>rubrikën 3</i> , të Rregullores të programit të studimit, janë përcaktuar objektivat e programit: - Përgatitja e teknikëve të aftë për të ndihmuar në komunitet; - Të përgatisë teknikë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë në zhvillim të bujqësisë; - Të përgatisë teknikë të aftë që të përballen me sfidat e kohës për të rritur prodhimin, përpunimin dhe menaxhimin e produkteve bujqësore; - Të përgatisë teknikë të aftë për të garantuar politika bashkëkohore të zhvillit rural të rajonit; Me qëllim përmbushjen e objektivave, është hartuar struktura e programit në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar.
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të qartë dhe të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që	Programet e studimit kanë objektiva të qartë dhe të përcaktuar në rregulloret përkatëse, duke u përshtatur me misionin e Fakultetit të Bujqësisë për përgatitjen e teknikëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e bujqësisë. Programi synon të zhvillojë aftësi dhe kompetenca të përparuara të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në fushën e specializuar. Kjo realizohet përmes

duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	zhvillimit të praktikave laboratorike në fushë dhe në ambiente profesionale të Ekonomisë Didaktike Eksperimentale, si dhe në ndërmarrje të shërbimeve bujqësore, bashkive dhe ferma private (Shtojca 4.1). Këto praktika përfshijnë punën me koleksionet e bimëve të ndryshme si bimët e arave, perimet, pemët, vreshtat dhe lulet. Qëllimi i këtyre praktikave është të sigurojë që studentët të zhvillojnë njohuri të nevojshme për të kuptuar parametrat e rëndësishëm për krijimin dhe menaxhimin e sipërmarrjeve profesionale në fushën e bujqësisë. Kjo përvojë praktike është në përputhje me objektivat dhe kompetencat profesionale të programit të studimit. Fakulteti, duke u bazuar në rregulloren e programit, siguron përfundimin e studimeve me objektiva dhe kompetenca profesionale të arrira nga studentët (Shtojca 4.1; Rregullore për programin e studimit).
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Plani mësimor i programit të studimit është i detajuar për çdo semestër dhe vit akademik. Ka të përcaktuar semestrin që zhvillohet lënda, nëse lënda është me detyrim apo me zgjedhje, veprimtarinë formuese të lëndës, numrin e krediteve, totalin e orëve në auditor të ndarë në leksione dhe seminare. Praktika profesionale në terren, orët e studimit individual, si dhe totalin e ngarkesës. Në çdo semestër ka një shpërndarje të barabartë 30 ECTS, 60 ECTS në vit dhe, 120 ECTS për dy vitet që zgjat programi profesional. Praktikat profesionale janë pjesë integrale e këtij programi, të cilat janë të planifikuara për të zhvilluar aftësitë praktike të studentëve në fushën e bujqësisë. Praktikat profesionale janë vlerësuar me 4 kredite (3.33%) që së bashku me lëndët e tjera plotësuese (Kategoria D) gjuhë e huaj dhe informatikë zënë 11% të totalit të krediteve. Detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) që përfshin mbrojtjen e tezës së diplomës është 7 kredite ose 5% të krediteve totale. (Shtojca 2.7 Plani mesimor te prog te stud)
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në	Programi profesional në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është organizuar në dy vite akademike me 120 kredite, duke u përshtatur me kërkesat ligjore dhe praktikat e pranimi të studentëve. Pranimi në këtë program është i hapur për maturantët, ndonëse ekziston një notë minimale mesatare e pranimi. Kjo përputhje me ligjin dhe specifikat e përcaktuara nga ministria e arsimit siguron që programi të funksionojë në përputhje me standardet dhe rregulloret e arsimit të lartë në vendin tonë. UniKo adreson mënyrën se si

kuadin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve përputhen me rregulloret ligjore dhe praktikatat e miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në rastin e programit studimor dy-vjeçar "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve", ky program nuk ka asnjë program tjetër studimi me karakter profesional dy-vjeçar në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtin emër. Pra, nuk mund të krahasohet përmbajtja e tij me të tjerët, pasi është unik në kategorinë e tij. Ky program studimi përmban një ofertë të specializuar për të përgatitur teknikë të specializuar për teknikat dhe teknologjitë e prodhimit të farave dhe fidanëve në fushën e bujqësisë, duke i dhënë një kontribut të rëndësishëm sipërmarrjeve në këtë sektor.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi profesional dy-vjeçar në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit sipas udhëzimeve kombëtare dhe evropiane. Për këtë program është propozuar kodi 52PP0811S, që e identifikon në mënyrë unike në sistemin e arsimit (Shtojca 8: Kodi i Programit të Studimit). Kjo përshtatje me klasifikimet dhe kodet e bëra publike siguron që programi të jetë i njohur dhe krahasueshëm në nivel vendas dhe ndërkombëtar, duke lejuar përkatësinë dhe cilësinë e studimit për të vlerësuar në një kontekst më të gjerë.
Konkluzione	<i>Programet e studimit në UniKo janë të organizuara në module dhe vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), në përputhje me legjislacionin vendas. Konkretisht, programi "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është i strukturuar në 120 kredite dhe ndjek nivelet 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i> <i>Programi synon të ofrojë njohuri dhe të zhvillojë aftësi profesionale në fushën e bujqësisë. Kjo arrihet përmes një stafi akademik të kualifikuar dhe praktikave profesionale në ambiente të ndryshme, për të përgatitur teknikë të specializuar.</i> <i>Programi ka objektiva të qartë për formimin profesional të studentëve, duke përshtatur dijet dhe aftësitë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Praktikatat laboratorike dhe në terren janë pjesë integrale për të zhvilluar aftësi praktike të studentëve.</i> <i>Ngarkesa në kredite është përcaktuar qartë për të gjitha</i>

	<i>lëndët/modulet, përfshirë praktikat profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, duke siguruar një përvojë të plotë arsimore për studentët.</i> <i>Organizimi dhe pranimi i studentëve janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</i> <i>Programi "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është unik dhe nuk ka programe të ngjashme për krahasim, duke përmbushur kërkesat për specializim në këtë fushë.</i> <i>Programi është kodifikuar në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe evropiane, duke e bërë atë të njohur dhe krahasueshëm në nivel vendas dhe ndërkombëtar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Universiteti "Fan S. Noli" Korçë përmbush kriteret e përcaktuara në pikën nr. 2, neni 20, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". UniKo është i përbërë nga katër njësi kryesore: 1. Fakulteti i Bujqësisë; 2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë; 3. Fakulteti i Ekonomisë; 4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane; Fakulteti i Bujqësisë përbëhet nga 3 departamente (njësi bazë): 1. Departamenti i Agrobiznesit; 2. Departamenti i Agronomisë; 3. Departamenti i Agroushqimit; Departamenti i Agronomisë gjatë dy viteve akademike ka

	përbërjen si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Gradat/Titujt/</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>MSc</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Totali</td><td>7</td><td>0</td><td>7</td><td>0</td></tr></table> Për sa i përket kualifikimeve të personelit akademik të Departamentit 85% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 15% janë Msc. Nga sa më sipër, njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Gradat/Titujt/	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	-	1	-	Prof.Assoc	3	-	3	-	Dr	2	-	2	-	MSc	1	-	1	-	Totali	7	0	7	0
Gradat/Titujt/	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr	1	-	1	-																															
Prof.Assoc	3	-	3	-																															
Dr	2	-	2	-																															
MSc	1	-	1	-																															
Totali	7	0	7	0																															
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	GVJ konstaton se është 1 (një) personel ndihmës akademik në Departamentin e Agronomisë. Personeli ndihmës akademik ka një eksperiencë dhe angazhohet për të realizuar orët e praktikave. Praktika profesionale zhvillohet pranë institucioneve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.																																		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Referaur RVB, përgjegjësi i departamentit, është koordinator i programeve të studimit. Në qershor 2019, Departamenti i Agronomisë caktoi koordinatorët për programet “Bachelor” në “Inxhinieri Agronomike” dhe “Master Profesional” në “Inxhinieri Agrare”, profili “hortikulturë”. Në shkurt 2023, departamenti miratoi koordinatorin e programit të studimit profesional dyvjeçar në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” (Shtojca 4.2: Vendimi për Koordinatorët e Programeve, Shtojca 4.3: Koordinatori i Programit të Studimit Profesional).																																		
Konkluzione	Programi i studimit profesional dyvjeçar në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" respekton rregulloret e																																		



	<i>brendshme të Departamentit të Agronomisë, Fakultetit të Bujqësisë dhe Universitetit "Fan S. Noli" Korçë. Këto rregullore janë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e UNIKO.</i> <i>Departamenti i Agronomisë ka një staf akademik prej 7 pedagogësh të kualifikuar dhe personel ndihmës akademik me mbi 10 vjet përvojë, i cili asiston në proceset mësimore, veçanërisht në praktikat dhe laboratorët. Kjo garanton realizimin efektiv të praktikave mësimore dhe laboratorike.</i> <i>Departamenti i Agronomisë ka caktuar një koordinator për programin e studimit profesional dyvjeçar në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve", i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Mbështetur në DVV, RVB si dhe takimet me drejtuesit e Programit të studimit, GVJ mori të gjithë informacionet e nevojshme, për të gjithë elementët e programit: organizimin, përmbajtjen dhe strukturën e tij. Të gjitha të dhënat jepen në: - Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli Korçë"; - Rregullore e njesise baze Departamenti i Agronomise; - Rregulloren e Programit të Studimit; - Plani mësimor; (Shtojca 1.2: Rregullorja e Universitetit; Shtojca 2.7: Plani Mësimor; Shtojca 2.3 Rregullore e njesise baze Departamenti i Agronomise).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për	Në rubrikën 4 të Rregullores të programit të studimit, është përcaktuar: - viti akademik i ndarë në dy semestra;

ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	- numri 30 i krediteve për semestër (60 ECTS për vit akademik); - Numri total i krediteve 120 ECTS; Në planin mësimor, lëndët janë të ndara në semestra, vite akademike, duke specifikuar kategorinë e lëndës, llojin e veprimtarisë, kodin, kreditet, ngarkesën e lëndëve në auditor (leksione, seminare, ushtrime), praktikën mësimore, orët e studimit individual dhe totalin e orëve brenda dhe jashtë auditorit. Programi përfshin 26 lëndë dhe module, me ngarkesë mësimore të vlerësuar në kredite.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Aplikimet për programin e studimit bëhen me anë të portalit <i>U -Albania</i>. Kriteret e pranimit, janë të hedhura në faqen <i>U -Albania</i>. Në Rregulloren e programit të studimit, <i>rubrika 9</i>, janë të përcaktuara procedurat e pranimit të studentëve. Kanë të drejtë të kandidateve për këtë program studimi: -kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm; -preferohen maturanët që vijnë nga shkolla e mesme profesionale me drejtim bujqësor; Programi i studimit ofron mundësi për njohjen dhe transferimin e krediteve, bazuar në Rregulloren e programit të studimit. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta në fillim të vitit akademik. Kriteret minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve janë 30 kredite të fituara. Numri maksimal i krediteve të njohura është në përputhje me përcaktimet e VKM 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. (Shtojca 2.5 Rregullorja e prog te stud TPDF)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në planin mësimor, për secilën lëndë, është dhënë viti, semestri, kategoria e lëndës, kreditet dhe ngarkesa e lëndës. Ngarkesa e lëndës është e përcaktuar në orë dhe kredite. Ndarja e orëve në një semestër, është në leksione, seminare, ushtrime, Laboratorë, praktikë profesionale dhe studim individual. Të gjithë këta komponentë janë të përcaktuara edhe në syllabuset e lëndëve. Syllabuset e çdo lënde janë të përgatitura në gjuhën shqipe dhe anglisht dhe janë të miratuara e depozituara në departament. Ato janë të disponueshme për studentët përmes web-it dhe Arkivës së Universitetit dhe prezantohen nga pedagogët në fillim të semestrit (Shtojca 5.1: Syllabuset; takimi me studentët).
Kriteri 5. Përmbajtja e	Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i administruar,

programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	GVJ konstaton se rishikimi i syllabuseve për përditësimin e materialeve bëhet në fillim të çdo viti akademik. Departamenti i Agronomisë përditëson dhe përmirëson vazhdimisht përmbajtjen e programit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e pedagogëve dhe studentëve. Të gjitha syllabuset janë të skeduar dhe të arkivuara në departament dhe dekanat (Shtojca 6.1: Procesverbalet e Përditësimeve, Shtojca 6.2: Arkiva e Syllabuseve; takimi me stafin akademik).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit dyvjeçar në "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është i strukturuar dhe mbështetur në rregulloret e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, rregulloren e programit të studimit dhe planin mësimor. Dokumentacioni përmban informacion të detajuar mbi kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> <i>Programi përmban 26 lëndë dhe module, me detaje mbi ngarkesën mësimore të secilës në kredite, si dhe orët në auditor dhe jashtë tij. Informacioni i plotë është i disponueshëm në rregulloren e programit dhe syllabuset e lëndëve.</i> <i>Programi përmban informacion të qartë dhe të detajuar mbi procedurat dhe kriteret për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, bazuar në ligjin për arsimin e lartë dhe rregulloren e brendshme të Departamentit të Agronomisë.</i> <i>Departamenti i Agronomisë përditëson dhe përmirëson vazhdimisht përmbajtjen e programit, duke arkivuar të gjitha syllabuset dhe procesverbalet e përditësimeve në departament dhe dekanat.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi,	Elementët e programit të studimit, emërtimi i lëndëve,

përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	struktura e vitit akademik, ndarja në orë e kredite janë në përputhje me parshikimet ligjore të nenit 70, të ligjit nr. 80/2015 dhe të VKM 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar në VKM nr. 879 datë 18.12.2019. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe e praktikave profesionale tendon drejt thellimit të njohurive dhe rritjes së kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve. Kjo shpërndarje mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Orët në auditor dhe jashtë tij i japin studentit informacionin e nevojshëm formimin e tij dhe përgatitjen për tregun e punës.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatojmë se programi i studimit është i shpërndarë në dy vite akademike, me dy semestra secili vit, me një ngarkesë totale 120 ECTS, ku në çdo vit akademik dhe semestër kanë të përcaktuara numrin e krediteve. Programi i studimit përmban 26 lëndë që zhvillohen në dy vite akademike. Tërësia e lëndëve që përbëjnë kurrikulën synon arritjen e objektivave të këtij programi dhe formimin profesional të studentëve sipas rezultateve të pritshme të të nxënit. Gjithsej zhvillohen 1468 orë mësimore e ndarë në 774 orë në vitin e parë akademik dhe 693 orë në vitin e dytë akademik.
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit ka një raport të balancuar midis formimit teorik dhe praktik (50:50), me rreth 25% të programit i dedikuar praktikës profesionale. Ky raport është në përputhje me profilin e programit dhe është i ngjashëm me programe ndërkombëtare, duke siguruar që studentët të marrin një formim të gjithanshëm dhe të plotë. Raporti 50:50 midis teorisë dhe praktikës është ideal për një program profesional, duke siguruar që studentët të jenë të përgatitur për sfidat praktike të tregut të punës.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Programi ka një ndarje të qartë të veprimtarive formuese dhe një raport të drejtë midis formimit teorik dhe praktik. Praktikën profesionale zhvillohen në institucione dhe sipërmarrje private, duke pajisur studentët me njohuri praktike të aplikuara në terren. Ndarja e veprimtarive dhe balancimi midis teorisë dhe praktikës janë mirë menduar për të mbështetur arritjen e objektivave të studimit dhe për të

mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	siguruar një bazë të fortë për punësim dhe mobilitete të studentëve.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	Çdo vit akademik, pedagogët përditësojnë syllabuset në përputhje me orët dhe kreditet e planeve mësimore dhe kërkesat e tregut të punës. Literatura bazë dhe ndihmëse përfshijnë materiale të miratuara dhe të përgatitura nga pedagogët, duke siguruar përmbajtje të përditësuar dhe relevante (Takimi me stafin akademik). Përditësimi i vazhdueshëm i syllabuseve dhe literaturës ndihmon në sigurimin e një edukimi cilësor dhe të përputhur me nevojat e tregut të punës.
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	UniKo ka marrëveshje të nënshkruara me institucione shtetërore dhe private që garantojnë cilësinë e praktikave profesionale dhe realizimin e temave të diplomës (Shtojca 2.10 . Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale). Bashkëpunimi me këto institucione siguron formimin praktik të studentëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. Bashkëpunimi i fortë me punëdhënësit dhe infrastruktura e mbështetur për praktikat profesionale janë thelbësore për formimin e studentëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. GVJ e konsideron si praktikë të mirë bashkëpunimin me fermerë lokalë dhe kompani bujqësore për të siguruar që programi i studimeve të përmbushë nevojat e tregut.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	Programi i studimit me karakter profesional "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është ndërtuar në përputhje me nivelin 5 të kualifikimeve, është në përputhje me ligjin nr. 80/2015, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Plotësimi i nevojave të tregut të punës me specialist të kësaj fushe, është objektiv i programit të studimit. Me qëllim plotësimin e këtij objekti është hartuar struktura kurrikulare e programit në përputhje me VKM nr. 41, datë 21.1.2018, e ndryshuar. Me anë të lëndëve karakterizuese si: Pedologji, Bimët e arave, ekologji bujqësore, mbrojtje bimësh, pemëtari, plehrta dhe plehrimi etj, studentët pajisen me njohuri dhe kompetenca të nevojshme, për të realizuar mirë funksionimin e teknikut të prodhimit të farave dhe fidanëve.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin 5 të KSHK dhe KEK.</i> <i>Rezultatet e të nxënësve, kompetencat e fituara në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>

	<i>GVJ konstaton se Raporti teori / praktikë është 50:50, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2 vjecar me karakter profesional.</i> <i>Lëndët dhe modulet janë shpërndarë në mënyrë të ekuilibruar midis veprimtarive formuese bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore. Kjo strukturë siguron një thellim të njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve, duke i përgatitur ata për punësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Institucioni siguron që gjatë hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit, propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës të merren në konsideratë. Për programin “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, Fakulteti i Bujqësisë ka zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve publike dhe private për të diskutuar aftësitë dhe kapacitetet profesionale që kërkohen nga punëdhënësit. Marrëveshjet e bashkëpunimit që janë nënshkruar me këto institucione garantojnë përputhjen e programit me kërkesat e tregut të punës dhe përmirësimin e përmbajtjes së tij (Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale). Procesi i përfshirjes së partnerëve dhe aktorëve të tregut të punës ndihmon në përmirësimin e përmbajtjes së programit dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur	UniKo, bazohet në parimin “Studenti në qendër”. Këshilli Studentor bashkëpunon me Senatin Akademik, për hartimin e strategjisë së çështjeve studentore. Studentët mund të shprehin mendimin e tyre përmes Këshillit të studentëve, vlerësimit të studentëve, peticioneve, kanë akses direkt tek drejtuesi i Departmentit, Dekani dhe Rektori për çështjet e mësimdhënies. Për çdo vit akademik dhe semestër, hartohen pyetësorë për studentë, me qëllim që të merret mendimi i

Handwritten signatures and initials.

ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	tyre, për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit. Studentët japin mendimin e tyre për metodat e mësimdhënies, materialet e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit etj. Mendimet dhe vlerësimet e studentëve aktualë dhe të diplomuar, merren në konsideratë në analizën e vjetore të punës të departamentit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. (Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	Departamenti i Agronomisë ka organizuar takime me përfaqësues të kompanive, rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private, me qëllim gërshetimin e teorisë me praktikën. Në planin mësimor orët e mësimi në auditor për të dy vitet akademike dhe semestra, i kanë kushtuar një peshë të barabartë raportit teori – praktikë. Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshje për zhvillimin e praktikës profesionale në terren dhe mban kontakt të vazhdueshëm me këto institucione për kërkesat që ato kanë për punësim në profilin e programit. UniKO ka një proces të mirëorganizuar për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Ajo përfshin detaje rreth bashkëpunimit me partnerët dhe monitorimit të progresit të studentëve, duke siguruar që programi të përputhet me zhvillimet e fundit në fushën e prodhimit dhe menaxhimit të farave dhe fidanëve. (Shtojca 3.12. Studim tregu pune periodik/ në kuadër hapjeje programi studimi).
Konkluzione	<i>Institucioni merr në konsideratë propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës për përmirësimin e programit të studimit. Fakulteti i Bujqësisë ka zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve publike dhe private, duke nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi që ndihmojnë në përshtatjen e programit me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Universiteti ka struktura të dedikuara si Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, të cilat përfshijnë studentët dhe të diplomuarit në diskutimet për përmirësimin e programit të studimit. Këshillat studentore në nivel fakulteti dhe institucioni janë aktive në konsultimet për përmirësimin e kurrikulës, duke reflektuar nevojat dhe sugjerimet e tyre në programin e studimit.</i>

	<i>Departamenti i Agronomisë përmirëson dhe përditëson programin e studimit në përputhje me zhvillimet e fundit dhe propozimet nga kompani, rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private. Departamenti bën një analizë të hollësishme përmes debateve, të cilat konkretizohen me vendimet përkatëse. Departamenti mban marrëdhënie të vazhdueshme me sipërmarrjet private bujqësore, duke ndjekur progresin e studentëve të punësuar dhe duke evidentuar çështjet për përmirësim në programin e studimit.</i> <i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Sipas akteve rregullatore UniKO ka të përcaktuara metodat e mësimdhënies. Ato ndërthurin: - Leksionet; - Seminarët; - punët laboratorike; - detyrat e kursit; - projektet; - praktikat profesionale; Mënyrat e mësimdhënies janë të përcaktuara në Syllabusin e secilës lëndë në mënyrë të detajuar, si dhe në planin mësimor të programit të studimit. Departamenti i Agronomisë, ka



	zhvilluar leksione të hapura me pedagogët dhe mësimet metodike me qëllim rritjen e cilësisë të mësimdhënies. Leksionet synojnë, të përmirësojnë mënyrat e mësimdhënies aktive që të nxisin të mësuarin aktiv, sipas qasjes studenti është në qendër të procesit. UniKo ka forma dhe metoda të mësimdhënies të qarta, të miratuara nga institucioni. Ajo tregon përkushtimin e institucionit për të përfshirë dhe përdorur metoda inovative dhe të ndryshme mësimdhënieje për të siguruar arritjen e rezultateve të të nxënës. GVI e konsideron praktikë të mirë përdorimin e pajisjeve moderne laboratorike dhe teknologjive të reja në mësimdhënie dhe kërkime, duke e bërë programin të përputhshëm me praktikën më të mirë ndërkombëtare. (Shtojca 3.24.Manual për mësimin online).
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se fusha e studimit dhe e specializimit e pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi, përputhet me lëndët me të cilat ata japin mësim. Pedagogët janë të angazhuar dhe në kualifikim të vazhdueshëm. Përmes anketimeve të ndryshme të realizuara me studentët, monitorohet aftësia mësimdhënëse dhe performanca e gjithë stafit akademik. Këto anketime realizohen në përfundim të çdo semestri akademik dhe rezultatet e tyre bëhen publike pas përfundimit të procesit të anketimit. Mbështetur në “Paktin për Universitetin”, anketimi i studentëve tani realizohet online në shkallë kombëtare, duke rritur pjesëmarrjen dhe lirinë e shprehjes së opinioneve të tyre.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	UniKO, kanë realizuar trajnime të stafit akademik në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies. UniKO ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete jashtë vendit me qëllim shkëmbimin e stafit pedagogjik, shkëmbimin e stafit administrativ, shkëmbimin e studentëve, mundësi zhvillimi së bashku e kërkimit shkencor, botimeve etj. Analizat e punës mësimore dhe shkencore të UNIKO-s dhe Fakultetit të Bujqësisë, duke përfshirë departamentin e agronomisë, ndihmojnë në identifikimin e sfidave dhe hartimin e masave për të përmirësuar përvojën e arsimit për të ardhmen. (Shtojca 3.8. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë; Shtojca 3.29. Analiza vjetore)
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor

mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit mendimin krijues dhe kritik te studentët. UniKo ka një staf akademik me përvojë të gjerë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbim për të tretët, i cili përdor teknika inovative të aplikuara në universitetet më të mira të rajonit të Ballkanit dhe Evropës. Për të përsosur metodat e mësimdhënies, njësitë bazë nxiten për përgatitjen dhe realizimin e leksioneve të hapura, dhe personeli akademik i ri merr pjesë në orë mësimore të zhvilluara nga pedagogët më me përvojë. Personeli akademik ka kompetencën dhe përkushtimin në përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënieje dhe në nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët. Kjo përfshin detaje mbi përvojën dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se Departamenti, përgjegjës për programin e studimit, pas analizës vjetore të punës, harton objektivat për vitin e ri akademik, si dhe planin e masave që duhet të merren me qëllim përmbushjen e këtyre objektivave të vendosura. Në fund të vitit akademik bëhet një rishikim i objektivave të vendosura nga departamenti, për të vlerësuar ecurinë e përmbushjes së tyre. Në këtë vlerësim përfshihen puna kërkimore -shkencore, mësimdhënia si dhe detyrat administrative dhe angazhimet të tjera në UniKo. NJSBC, harton pyetësorë për studentët, stafin akademik me qëllim evidentimin e eksperiencave pozitive dhe problematikave. Rezultatet diskutohen në mbledhjet periodike të departamentit, ku përcaktohen edhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësim të mëtejshëm.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të	Uniko shfaq një përkushtim të vazhdueshëm ndaj përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet organizimit të strukturave dhe njësive në nivel institucional. Duke koordinuar dhe bashkërenduar aktivitetet me fakultetet dhe njësitë bazë, Uniko promovon eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies, duke ofruar trajnime të vazhdueshme për personelin akademik dhe ndihmësin akademik. Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional monitoron dhe koordinon vlerësimin e cilësisë në të gjitha nivelet akademike dhe shkencore të universitetit. Në bashkëpunim me komisionet dhe strukturat tjera si Qendra për Formimin e Vazhdueshëm dhe Qendra e Inovacionit, Uniko siguron një mjedis ku përmirësimi i aftësive të mësimdhënies është një proces i vazhdueshëm dhe

reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	i përkushtuar.			
Konkluzione	<i>Institucioni ofron një shumëllojshmëri formatësh mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, duke përdorur metodat e miratuara dhe duke përshtatur praktikat në fushën e studimeve.</i> <i>Personeli akademik respekton dhe përgjigjet ndaj larmisë dhe nevojave të studentëve, duke përfshirë ata në procesin e vlerësimit të performancës akademike</i> <i>Institucioni mbështet përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike të personelit akademik, duke monitoruar dhe siguruar cilësinë në nivel universiteti.</i> <i>Personeli akademik është kompetent dhe përdor metoda të ndryshme mësimdhënieje për të nxitur mendimin krijues dhe kritik të studentëve.</i> <i>Njësitë përgjegjëse për programin e studimit vlerësojnë dhe përmirësojnë format e metodat e mësimdhënies duke përfshirë studentët në këtë proces.</i> <i>Institucioni organizon struktura dhe njësi që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe trajnojnë personelin akademik për përmirësimin e aftësive të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se vlerësimi i studentëve është përcaktuar në disa rregullore specifike, duke përfshirë Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit të Bujqësisë dhe Rregulloren e Departamentit të Agronomisë. Këto rregullore përcaktojnë qartë sistemin e vlerësimit,

programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	kushtet për hyrje në provime, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurat e ankimimit për studentët që janë të pakënaqur me rezultatet e tyre (Shtojca 3.1, 3.2, 3.3). Këto rregullore janë të publikuara dhe të njohura për studentët, duke siguruar transparencë dhe qartësi në procesin e vlerësimit. Universiteti ka krijuar një sistem të mirë-strukturuar dhe të qartë për vlerësimin e studentëve, duke siguruar që të gjitha palët e përfshira të jenë të informuara dhe të vetëdijshme për procedurat dhe kërkesat.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo lënde apo moduli, studentët informohen në detaje për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Testimi dhe vlerësimi ndahet në dy pjesë: vlerësimi vazhduar, që përfshin deri në 30% të totalit të pikëve, dhe provimi përfundimtar, që përfshin deri në 70%. Vlerësimi vazhduar mund të përfshijë frekuentimin, angazhimin në laboratorë, seminare, ushtrime dhe projekturse, në diskrecionin e pedagogut. Provimi përfundimtar mund të realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë (Shtojca 3.4, 3.5). Informimi i detajuar i studentëve në fillim të çdo lënde siguron që ata të jenë të vetëdijshëm për kërkesat dhe metodologjinë e vlerësimit, duke ndihmuar në përgatitjen e tyre të suksesshme për provime dhe detyra.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Bazuar në syllabuset, konstatojmë se testimi i njohurive është i bazuar në vlerësimin e vazhdueshmëm të studentëve. Pedagogët kanë mundësi të ndjekin progresin e studentëve gjatë semestrit (të gjithë lëndët që ofrohen nga programi i studimit janë semestrale), dhe t'i ndihmojnë ata për të kapërcyer vështirë që hasin gjatë kursit. Universiteti përdor një shumëllojshmëri metodash vlerësimi për të mbuluar të gjitha aspektet e njohurive dhe aftësive të studentëve, duke rritur kështu mundësitë për studentët që të tregojnë kompetencat e tyre në mënyrë gjithëpërfshirëse. Projekti CleanScore shton një shtresë shtesë transparence dhe ndershmërie në procesin e vlerësimit. (Shtojca 3.6, 3.7)..
Konkluzione	<i>Universiteti "Fan S. Noli" Korçë ka implementuar rregullore të qarta dhe transparente për testimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve.</i> <i>Informimi i detajuar i studentëve dhe përdorimi i metodave të ndryshme vlerësimi sigurojnë që të gjitha palët janë të informuara dhe të vetëdijshme për procedurat dhe kërkesat.</i>

	<i>Projekti CleanScore përmirëson transparencën dhe ndershmërinë në procesin e vlerësimit. Këto masa tregojnë se institucioni plotëson plotësisht standardin e kërkuar.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar DVV dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se UniKO siguron që vlerësimi i studentëve të realizohet në dy faza kryesore: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit (30%) dhe vlerësimi përfundimtar (70%). Pikët e grumbulluara gjatë vitit regjistrohen në sistemin Pitagora dhe ruhen për t'u përdorur në sezonet e ardhshme, në rast se studenti është ngelës (Shtojca 1.6. Manual i sistemit elektronik Pitagora). Ky sistem siguron një ndarje të qartë të përgjegjësisë të vlerësimit dhe është i detajuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti ka implementuar sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit, duke përfshirë projektin CleanScore, i cili rrit transparencën dhe shmang abuzimet në vlerësim. Ky projekt përfshin korrigjimin e automatizuar të provimeve dhe përkthimin e teksteve akademike në shqip, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën në vlerësim.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar kryhet në përputhje me syllabusin dhe ligjin. Komisioni i provimit, që përbëhet nga dy pedagogë, garanton integritetin e vlerësimit. Rezultatet hidhen në sistemin e vlerësimit dhe publikohen online brenda afateve të përcaktuara. Ekzistojnë procedura të qarta për kundërshtimin e rezultateve nga studentët, të cilat janë transparente dhe dokumentohen me kujdes.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të	Studentët marrin feedback dhe këshilla gjatë gjithë procesit mësimor për të përmirësuar performancën e tyre. Kriteret e frekuentimit dhe vlerësimi i vazhduar janë të qarta dhe bëhen të ditura studentëve në fillim të semestrit. Sipas udhëzimit të ministres së arsimit rinisë dhe sporteve, studentët duhet të frekuentojnë 75% të leksioneve, laboratorëve dhe seminareve

nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	për të fituar të drejtën për të hyrë në provim.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni ka masa të rrepta për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Çdo shkelje trajtohet sipas rregullores dhe shoqërohet me masa disiplinore. Këto masa sigurojnë një mjedis akademik të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë studentët.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Kontrolli i dijeve realizohet në forma të ndryshme dhe rezultatet publikohen brenda afateve të përcaktuara. Notat bazohen në një sistem të qartë pikësh dhe përfshijnë një proces transparent të konvertimit të pikëve në nota. Ky sistem siguron që çdo student të marrë një vlerësim të drejtë dhe të bazuar në performancën e tij akademike.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për të njohur vlerësimet dhe për të kërkuar rishikim. Ankesat trajtohen nga dekanati dhe vendimet janë të formës së prerë (Shtojca 1.2. Rregullore e Universitetit "Fan S.Noli" Korçë). Kjo siguron që procesi i ankimimit të jetë i drejtë dhe transparent për të gjithë studentët.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Procedurat për shqyrtimin e ankesave janë të qarta, transparente dhe të dokumentuara. Ankesat shqyrtohen nga komisione të posaçme dhe dokumentohen në mënyrë të detajuar. Kjo praktikë siguron një proces të drejtë dhe të ndershëm për të gjitha palët e përfshira.
Konkluzione	<i>Universiteti "Fan S. Noli" Korçë siguron një proces vlerësimi të drejtë dhe transparent për studentët, duke përfshirë edhe mundësinë e ankimimit.</i> <i>Vlerësimi bëhet në dy faza gjatë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Përdorimi i sistemeve elektronike si Pitagora dhe projekti CleanScore shmang abuzimet dhe rrit transparencën.</i> <i>Procedurat e vlerësimit janë të përputhura me syllabusin dhe ligjin, dhe komisionet e provimit sigurojnë integritetin e rezultateve.</i>

	<i>Studentët marrin feedback të rregullt dhe këshilla për përmirësimin e performancës së tyre.</i> <i>Institucioni ka masa të rrepta kundër plagjiaturës dhe kopjimit, dhe garanton të drejtat e studentëve për rishikim të vlerësimeve dhe ankimime të dokumentuara e transparente. Këto masa tregojnë përmbushjen e plotë të standardit për vlerësim të drejtë dhe transparent.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit me karakter profesional "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve", është një program me karakter profesional dhe si i tillë është i detajuar, informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formues të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit. Programi balancon aftësitë e formimit teorik me ato praktik, me një raport 50% / 50% midis njohurive teorike me ato praktike. Në përmbajtjen e tij, programi përmban si lëndët bazë, ashtu edhe ato karakterizuese. (Shtojca 1.16. Manuali i Cilësisë Uniko).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit, garanton zhvillimin e aftësive të vecanta ne fushën e fidaneve dhe farave. Programi i studimit profesional dy vjeçar përmban lëndë e module që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e legjislacionit, ndërveprimit, ku futet një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese, Nëpërmjet këtyre lëndëve studentët zgjerojnë njohuritë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre për një menaxhim më të mirë në fushën e prodhimit dhe tregtimit të farave dhe fidanëve (Shtojca 2.8 Programet lendore te programeve te studimit (Syllabuset)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e	Duke u bazuar ne rregulloren e departamentit, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duhet të analizohen e

studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	shqyrtohen në përfundim të lëndës. Nga takimet vumë re se në disa raste organizohen mbledhje departamenti të vecanta, por edhe sondazhe, anketime dhe biseda me studentët, ku diskutohen çështjet më të rëndësishme të modulit, orientohen studentët dhe ju sqarohen atyre detyrimet përmbyllëse. (Shtojca 2.3 Rregullore e njesise baze Departamenti i Agronomise, Shtojca 2.5 Rregullorja e prog te stud TPFF).
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i studimit profesional, përfshin orët e laboratorit dhe praktikës profesionale. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra gjatë këtyre orëve. Në projekte apo detyra ne grup, personeli akademik nxit dhe mbështet diskutimet dhe debatet për gjetjen e zgjidhjes te problemeve të ndryshme. Universiteti i Korces, Fakulteti dhe departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrje prodhuese të industrive të ndryshme, ku studentët kryejnë praktika profesionale duke mundësuar zbatimin konkret të njohurive dhe rritur mobilitetet e tyre (Shtojca 2.10 mareveshj bashkepun ne mbeshtje te prakt profesn, Shtojca 4.7 Tabela e te dhenave infrastrukture ne funks te prog te stud).)
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga takimet me personelin akademik, u tregua se stafi organizon orë të hapura leksioni apo seminare, konferenca shkencore dhe workshop-e, gjatë të cilave, personeli akademik diskuton mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë si brenda ashtu edhe jashtë strukturës së programit të studimit (Shtojca 3.18. Shembull i orëve të hapura).
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato, në përputhje dhe me strategjinë e institucionit.</i> <i>Personeli akademik nxitet të përdorë metoda inovative të mësimdhënies të cilat nxisin tek studentët mendimin kritik dhe aftësimin praktik në përshtatje me kërkesat dhe objektivat formues të programit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Në bazë të rregulloreve, Universiteti i Korces dhe Fakulteti i Bujqesise, kanë hartuar procedura të posacme për detyrimet përmbyllëse, si parashikon mundësinë e provimit përfundimtar të diplomës. Datat e Provimit Përfundimtar dhe çdo informacion tjetër që lidhet me to, ju komunikohen paraprakisht studentëve si dhe afishohen në ambiente të posacme të Fakultetit, online në faqen web të UK, si edhe në sistemin elektronik Pitagora (Shtojca 4.15 Manual perdorimi fq zyrtare e UNIKO, Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA, Shtojca 2.2. Rregullore e njesisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 2.3 Rregullore e njesise baze Departamenti i Agronomise, Shtojca 2.5 Rregullorja e prog te stud TPFF).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Duke u bazuar në rregullore, Departamentit i agronomise, si struktura përgjegjëse për këtë program studimi, i njeh studentët dhe afishon listën e temave dhe pyetjeve që do përfshihen në provimin përfundimtar të diplomimit, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të ketij detyrimi përmbyllës (Shtojca 2.2. Rregullore e njesisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 2.3 Rregullore e njesise baze Departamenti i Agronomise, Shtojca 2.5 Rregullorja e prog te stud TPFF).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i diplomimit zhvillohet pas përfundimit të provimeve të lëndëve të semesrit të dytë të vitit të dytë. Provimi bazohet në lëndët kryesore karakterizuese sipas fushës së programit. Departamenti cakton komisionin e posaçëm, që miratohet nga dekani i FB-së, për administrimin e provimit të diplomës. Komisioni i provimit të një lënde (moduli) përbëhet nga jo me pak se dy vetë, nga të cilët njeri duhet të jetë pedagogu i lëndës (modulit). Nëse titullari i lëndës apo anëtar i tjetër, për arsye madhore, nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton me shkrim pedagogun që do t'i zëvendësojë (Shtojca 2.2. Rregullore e njesisë kryesore

	Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 2.3 Rregullore e njesise baze Departamenti i Agronomise, Shtojca 2.5 Rregullorja e prog te stud TPDF).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga departamenti u njohëm se diplomimi i studentëve në këtë program studimi, bëhet me provim formimi, ku studenti hyn pasi ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj lëndëve të përfshira në program. Studentit i jepet materiali, i cili përmban pyetjet e provimit të formimit për diplomë, 1 muaj para datës së provimit të formimit. Ky material i ndihmon dhe i orienton studentët në përgatitjen e provimit të formimit. Departamenti i Agronomisë paraprakisht për programin e studimit profesional dy vjeçar në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, përcakton listën e temave për diploma në fillim të semestrit të tretë. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. Drejtuesit e tezave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Per provimin e formimit, mënyrën se si do të përgatiten dhe se si do të zhvillohet tezat dhe modalitete të tjera, janë të pasqyruara në rregulloret përkatëse të programeve të studimit. (Shtojca 3.25 Regjistrimi dhe diplomimi i studenteve).
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Referuar RVB, Departamentit të Agronomisë i ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e Fakultetit të Bujqësisë, në EDE, apo jashtë universitetit në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit. Studentëve ju vihet në dispozicion çdo aparaturë, pajisje apo mjet që disponojnë laboratorët e fakultetit për kryerjen e matjeve, analizave e testeve që kërkohen për realizimin e temave të studimit (Shtojca 3.5 Tabela e instituc bashkep per praktikat).
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, student i vlerësohet me notë.	Vlerësimi me notë në përfundim të provimit përfundimtar të diplomës së studentit është e parashikuar nga aktet e brendshme të institucionit. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota pesë. (Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 2.3 Rregullore e njesise baze Departamenti i Agronomise, Shtojca 2.5 Rregullorja e prog

	te stud TPFF).			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, në përfundim të studimeve në programin e studimit: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës dhe rektori i universitetit. (Shtojca 1.1 Statuti i UK, Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 2.6. Modeli i diplomës së programit të studimit).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni administron kopje të dokumentacionit të studentit që nga momenti i regjstrimit në program, deri në momentin e diplomimit. Ky dokumentacion ruhet në arkivën e Sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit në rektorat, në përputhje me legjislacionin për arkivat. Studentët ose të diplomuarit kanë të drejtë të marrin informacion në lidhje me programin e studimit që ata kanë ndjekur. Vënia në dispozicion e informacionit realizohet sipas procedurave të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore. (Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale).			
Konkluzione	<i>Institucioni në aktet rregullatore ka përcaktime të detajuara lidhur me mënyrën e përfundimit të studimeve akademike si dhe procedurën e realizimit të provimit të diplomimit. I gjithë procesi është publik dhe u bëhet i njohur studentëve.</i> <i>Studentët mbështeten dhe orientojnë nga pedagogët në këtë proces. Institucioni administron në përputhje me legjislacionin në fuqi dokumentacionin e studentit që nga momenti i regjstrimit në program, deri në momentin e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe

monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UNIKO ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve, si dhe udhëzues që lidhen me mësimin në distancë. Për të integruar personelin akademik, UNIKO ka ndjekur politikën e përfshirjes në projekte dhe veprimtari të ndryshme shkencore. Personeli akademik nxitet vazhdimisht për të realizuar kualifikime apo specializime, si pjesë e përpërimit akademik të tyre e veçanërisht në funksion të mësimdhënies (Shtojcën 2.15. Veprimtaria shkencore e stafit akademik).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Ne takimin e patur me Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, të UNIKO, funksioni i tyre ishte në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës. Kjo njësi mbështetet dhe nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë në IAL dhe Komisioni për Sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultet. Punonjësit e kësaj Njësie na sqaruan për punët e tyre dhe sidomos në zhvillimin e pyetësorëve për studentët, por që nuk bëhet në mënyrë periodike dhe të rregullt. (Shtojca 3.4. Lista e NJSBC, Shtojca 3.27 Te dhena per NJSBC, Shtojca 3.7 Raporti vjetor i NJSBC fakulteti i bujqesise)
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga dokumentat në dispozicion shihet që pranë UNIKO është ngritur dhe funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës. Nëpërmjet anketimeve që kryejnë studentët vlerësohet edhe puna që realizohet nga stafi akademik i Fakultetit të Bujqësisë (Shtojca 3.29 Analiza vjetore e UNIKO, Shtojca 3.4. Lista e NJSBC)
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni ka një sërë mekanizmash me të cilat vlerëson rezultatet që vijnë nga monitorimi i brendshëm i cilësisë. Rezultatet e monitorimit janë pjesë e raporteve që hartohen në kuadrin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NJSBC, raportet vjetore në nivel instiucional apo raportet e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Këto raporte i shërbejnë nxjerrjes së konkluzioneve në lidhje me marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në mënyrë që monitorimi të jetë sa më efikas dhe të mundësohet

	sa më shpejt marrja e masave për përmirësimin e cilësisë, raportet e NJSBC realizohen në baza semesrale. Në funksion të konkluzioneve që dalin nga këto raporte, institucioni marr masat e duhura që i shërbejnë përmirësimit të performancës së stafit akademik si, trajnime apo aktivitete që synojnë kualifikimin akademik. Institucioni përdor gjithashtu mekanizma stimulues të personelit me performancë positive. (Shtojca 3.29 Analiza vjetore e UNIKO).			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika si dhe ngritur struktura për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Aftësia e mësimdhënies vlerësohet dhe monitorohet si pjesë e mekanizmave të vlerësimit të cilësisë.</i> <i>Rezultatet e vlerësimit bëhen publike dhe shërbejnë për promovimin e shembujve të mirë si dhe marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të performancës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
-----------------	------------------

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në evidenca dhe takime, personeli akademik dhe ndihmës akademik, që është i angazhuar për realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik. Personeli akademik i përfshirë, mbulon lëndët/ modulet e programit, dhe kanë relativisht experience në fushat kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe vecorinë e moduleve. Cv dhe dosjet e personelit nuk janë të gjitha uniforme, dhe nuk janë paraqitur të gjitha Cv, sipas emrave të dhënë, për personelin me kohë të plotë dhe të pjesshëm (Shtojca 4.1 tabela e personelit akademik te angazhuar ne prog e stud., Shtojca 4.8 Tab e te dhenave per kualifikim dhe kerkim shkenc. Shtojca 4.12 stafi akademik iFB). Në dosje janë paraqitur të dhëna për stafin mësimdhënës për programin e studimit për dy vite akademike me kualifikimim sim ë poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Titujt grada</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.</td><td>4</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/Phd.</td><td>5</td><td>-</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>3</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td></tr><tr><td>Totali</td><td>13</td><td>1</td><td>13</td><td>1</td></tr></table>	Titujt grada	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	-	1	-	Prof.As.	4	-	4	-	Dr/Phd.	5	-	5	-	Msc.	3	1	3	1	Totali	13	1	13	1
Titujt grada	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr.	1	-	1	-																															
Prof.As.	4	-	4	-																															
Dr/Phd.	5	-	5	-																															
Msc.	3	1	3	1																															
Totali	13	1	13	1																															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Mbulimi i ngarkesës mësimore në këtë program studimi realizohet kryesisht nga PAE. Raporti PAE / PAK për të dy vitet akademike është si vijon: - për të dy vitet akademike janë të angazhuar 14 pedagogë gjithsej, ndër të cilët 13 PAE / 1 PAK. Mbulimi i programit në përqindje si numër fizik është 92% PAE dhe 8% PAK. Për sa i takon ngarkesës mësimore nga të dhënat e institucionit rezulton se për të dy vitet akademike stafi akademik efektiv mbulon 96 % të ngarkesës. Nga sa më sipër rezulton se stafi akademik efektik e mbulon me mbi 70% ngarkesën mësimore, në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi.																																		
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë	Institucioni garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Aktet e brendshme të																																		

qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	institucionit parashikojnë rregullime lidhur me procedurat e rekrutimit dhe punësimit të stafit akademik. Këto rregullime janë në përputhje me Kodin e Punës si dhe legjislacionin që i referohet arsimit të lartë. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se për tre vite akademike është i njëjti staf mësimdhënës. (Shtojca 4.2 Tabela e ngarkesës së stafit akademik të angazhuar në të gjithë prog, Shtojca 4.14 Ngarkesa e plot mesimore e stafit të dep. të Agronomisë)
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Punësimi i personelit akademik bëhet me procedurë të konkurrencës të hapur. Shpallja e vendeve vakante bëhet me kërkesë të drejtuesit të njësisë bazë në përputhje me nevojat e kësaj njësie. Kriteret e punësimit përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga Rektori. Kriteret e veçanta përcaktohen nga departamenti sipas fushës dhe lëndëve që pedagogu do të japë mësim Kriteret e përgjithshme janë përcaktuar në statutin dhe rregulloren e UNIKO. Njësia bazë përcakton kriteret për përzgjedhjen e nivelit të kualifikimit me natyrën dhe përmbajtjen e programit të studimit. (Shtojca 1.1 Statuti i UK, Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO, Shtojca 1.13 Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik).
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Departamenti i Agronomisë, ka 1 personel ndihmës akademik, i cili ka përvojën dhe kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e punëve që i ngarkohen. (Shtojca 2.17 Jetëshkrimi i stafit ndihmes akademik. Shtojca 4.7 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të prog të stud)
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të	Institucioni ruan dhe administron të gjitha të dhënat lidhur me burimet njerëzore të përfshira në programin e studimit. Këto të dhëna janë ruajtur dhe administrohen që në vitin e parë akademik të hapjes së këtij programi studimi dhe deri aktualisht. Ruajtja e të dhënave mbi burimet njerëzore të përfshira në këtë program studimi, është në radhë të parë përgjegjësi e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Nga takimi i zhvilluar me përgjegjësin e kësaj zyre, u

personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	konstatua se administrohen si dosjet e personelit akademik me kohë të plotë, ashtu edhe atij me kontratë. Dosjet kanë në përmbajtje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Nga GJVJ u konstatua rinovimi i dosjeve edhe me çdo element të ri, përfshirë edhe ndryshimet në lidhje me kualifikimin akademik të stafit. (Shtojca 1.23. Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, Shtojca 1.13. Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik, <u>Shtojca 2.7 Plani mesimor të prog të stud 1 vit</u>).
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Duke ju referuar dokumentave dhe meqënëse natyra e programit të studimit është profesional, Institucioni ka marrëveshje dhe bashkëpunime me institucione të tjera, sidomos kompani e biznese private dhe publike për realizimin e praktikave profesionale, apo veprimtarive të tjera. Meqënëse numri i studentëve është relativisht i ulët, krahasuar me numrin e personeli akademik, mbikqyrja e studentëve në praktikën profesionale, instruktimi dhe udhëheqja bëhen në raporte të mira, dhe kontrolli i raporteve të punës kryhet mirë. Institucione dhe sipërmarrje të angazhuara me studentët tanë janë: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë, Instituti i Pemëtarisë Vlorë, AREB Korçë, ARSHVMB, AKU Korçë, kompani të prodhimit të farave dhe fidanëve. (Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale, Shtojca 2.10 dhe 3.5. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale dhe Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikat)
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Duke ju referuar takimit, në mjediset pritëse, angazhohet personeli mbikqyrës, dhe këto realizohen në bazë të marrëveshjeve për Praktikën profesionale, për të treguar infrastrukturën dhe procesin e punës. Krahas mbikqyrësit që ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve, ka dhe staf akademik që vlerëson raportin përfundimtar të praktikës, si dhe realizon procesin e vlerësimit për praktikën profesionale. (Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale, Shtojca 2.10 dhe 3.5. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale dhe Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikat), <i>Rekomandohet të rishihen raportet përfundimtare me mirë nga stafi akademik, meqë numri i studentëve është më i vogël, krahasuar me numrin e personelit akademik.</i>

Konkluzione	<i>Departamenti i Agronomisë ku zhvillohet ky program studimi, përbëhet nga stafi akademik efektiv (PAE) dhe stafi akademik me kontratë (PAK). Raporti PAE/PAK në mbulimin e ngarkesës mësimore është në përputhje me rregullimet ligjore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Duke ju referuar dokumentave, FB/UNIKO, ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit mësimor, si dhe për zhvillimin e punëve laboratorike, të ndara në kursë leksione, grupe seminari dhe laborator, ku përfshihen auditorët dhe laboratorët mësimor, në përshtatje me natyrën specifike të programit apo moduleve të veçanta të tij. Ambientet janë të paisura më të gjitha mjetet e nevojshme që mundësojnë zhvillimin normal të aktivitetit mësimdhënës në funksion të stafit, studentëve dhe shërbimeve. (Shtojca 4.7 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funks të prog të stud.)
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore në godinën ku zhvillohej procesi mësimdhënës në këtë program studimi ishin paisur më të gjitha mjetet që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore si dhe realizimin me sukses të programit të studimit. Si studentët ashtu edhe stafi akademik, kanë akses në këto sisteme. Të gjitha sallat dhe ambientet e mësimdhënies janë të paisura me Lab Top, me video projektorë si dhe me dërrasë të zezë. Në të gjitha ambientet funksionon sistemi i kondicionimit. Në të gjitha mjediset ka akses të palimituar në internet. (Shtojca 4.7 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funks të prog të stud.)
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e	Ambientet në funksion të procesit të mësimdhënies janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme që mundësojnë

praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	zhvillimin normal të aktivitetit mësimor si dhe realizimin me sukses të programit profesional të studimit. Godina ku ushtrohej aktiviteti mësimdhënës ishte e paisur edhe me sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, shkallët e emergjencës si dhe sistemin e fonisë që ndihmon në realizimin me sukses të aktiviteteve shkencore. Gjithashtu edhe laboratorët ishin të paisur me të gjitha programet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor në programet profesionale sipas profileve. Për qëllimet e realizimit të praktikave mësimore, UNIKO ka në dispozicion, koleksione me pemë dhe perime pranë Ekonomisë Didaktike Eksperimentale (EDE) me sipërfaqe prej 19 Ha, bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Korçë dhe në hapësirat që krijojnë sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor. (Shtojca 2.10 mareveshje bashkepun ne mbeshtje te prakt profesn, Shtojca 4.7 Tabela e te dhenave infrastrukturore ne funks te prog te stud.).			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në Fakultetin e Bujqesise, konstatuam se <u>ka disa mjedise</u> mësimore të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor të karakterit teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive dhe metodave bashkëkohore (Shtojca 4.7 Tabela e te dhenave infrastrukturore ne funks te prog te stud.).			
Konkluzione	<i>Ambientet në funksion të procesit të mësimdhënies janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme që mundësojnë zhvillimin normal të aktivitetit mësimor si dhe realizimin me sukses të programit profesional të studimit "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në	Nga takimi me studentet dhe vizita ne mjediset e Bibliotekes se UNIKO, u konstatua se studentëve ju vihet në dispozicion

dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	literatura bazë fizike, materiale të shkruara si dhe marrja me shkrim, për realizimin e programit të studimit. Kjo literature është përgatitur nga personeli i angazhuar sipas lëndëve dhe moduleve. Studentët kane një fond jo shumë të madh të librave të lëndëve apo moduleve në shqip në Bibliotekën e UNIKO. <i>U konstatua se <u>mungonin libra</u> të botuar për këtë drejtim nga anëtarët e FB, për vetë numrin e vogël të studentëve përveç lenëve të përgjithshme që janë dhe në degët e tjera (si kimia, etj.)</i> Krahas kësaj, garantohet dhe literaturë ndihmëse. Në programet mësimore të çdo lënde apo moduli përcaktohet literatura bazë dhe literatura ndihmëse që mund të shfrytëzojnë studentët. Literatura bazë përbëhet nga tekstet mësimore, dispensat, praktikumet, që mund të gjenden në bibliotekë. Literatura ndihmëse mund të gjendet në bibliotekën e fakultetit ose në bibliotekën e Uniko. (Shtojca 2.8. Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset), Shtojca 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke, Shtojca 4.7. Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	FB si pjesë e UNIKO, ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë me disa mjedise dhe hapësira të mjaftueshme, ku studentët gjejnë kushte sa më optimale për shfrytëzimin e saj. Fondi është aktualisht i shpërndarë në pesë mjedise dhe përkatësisht në: Biblioteka Shkencore Universitare (Rektorat), Bibliotekën e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Bibliotekën e Fakultetit Ekonomik, Bibliotekën e Fakultetit të Bujqësisë, Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane. Në Bibliotekën online gjendet një literaturë bashkëkohore, e cila mbulon fushat parësore të kërkimit në Universitet, si në fushën e edukimit, bujqësisë, ekonomisë, shkencat filologjike, shkencat sociale, natyrore, mjekësore, etj (Shtojca 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke).
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme	Duke ju referuar DVV, themi se Biblioteka e UNIKO ka në fondin e saj dhe vë në dispozicion të studentëve disa prej teksteve mësimore dhe literaturë të rekomanduar në gjuhë shqipe apo të huaj, programin e studimit që ofron Departamenti i Agronomisë. Modulet dhe veprimtaria mësimore e programit mbulohet nga një numër i vogël tekstesh dhe disa revistash shkencore, të cilat mbulojnë thuajse të gjitha modulet dhe veprimtaritë e programit

dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	mësimor. Fondi total i librave të bibliotekës është 2210, Fondi i titujve të librave të bibliotekës është 1479, Fondi i librave në gjuhën shqipe është 1540 libra, nga këta: 920 libra i përkasin fushës së bujqësisë. 310 libra i përkasin fushës së blegtorisë. 310 libra i përkasin fushës së ekonomisë. Fondi i librave në gjuhën e huaj janë 670 libra të fushave të ndryshme. Janë blerë 50 tituj librash. Dhurime nga të tjerë 1429 tituj librash. (Shtojca 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke).
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Përdorimi i bibliotekës mundësohet pa pagesë për të gjithë studentët dhe stafin akademik të UNIKO. Institucioni kishte krijuar mundësi për akses të barabartë për studentët, personelin akademik dhe të interesuarit në funksion të procesit mësimor, formimit profesional dhe veprimtarisë shkencore të institucionit. Që nga viti 2018 ofrohet një mundësi e re qasjeje në Bibliotekën online Jstore-mundësuar nga AADF, Ebsco-mundësuar nga RASH. (Shtojca 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke, Shtojca 1.6 Marreveshja me RASH per sist elektronik PITAGORA).
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	Referuar RVB, biblioteka e Universitetit / Fakultetit të Bujqësisë janë të pajisura me programe kompjuterike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët e “Programit të studimit profesional 2 vjeçar” në “Teknika të Prodhimit të Farave dhe Fidanëve”, <u>por për vetë nivelin e studentëve, pak shfrytëzohen këto programe kompjuterike.</u> (Shtojca 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke, Shtojca 1.6 Marreveshja me RASH per sist elektronik PITAGORA)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Për të mundësuar shfrytëzimin e barabartë të mjediseve të bibliotekës, biblioteka qëndronte e hapur deri në orën 16. Ky orar është një orar i përshtatshëm, për studentët. Biblioteka në baze të kapacitetit të saj, përmbush nevojat e studentëve, dhe numrin e studentëve që e shfrytëzojnë atë, brenda orarit të shërbimit të saj. Rreth 2000 studentë dhe 183 pedagogë kanë kartelat e tyre personale në këto biblioteka. (Shtojca 4.10. Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë në funksion të programit
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të	Personeli akademik, informon bibliotekën për tituj të rinj, duke realizuar pasurimin e fondit të bibliotekës në mënyrë të

programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	vazhdueshmë. Njësia bazë ndjek programin e studimit si dhe njofton bibliotekën për të ndjekur pasurimin e fondit të saj të librit. Si pjesë e analizave vjetore institucionale, janë të dhënat mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik, të bibliotekës së UNIKO. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e çdo programi studimi e pa pagesë. Një pjesë e teksteve mësimore dhe dispensave që kanë lidhje me lëndët e modulet e që zhvillohen në programin e studimit profesional dy vjeçar në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, gjenden si në Bibliotekën e UNIKO ashtu edhe në bibliotekën e Fakultetit të Bujqësisë. (Shtojca 4.10. Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë në funksion të programit)			
Konkluzione	<i>GVJ mendos se ky standard përmbushet kryesisht sepse megjithëse libra ka, librat për këte drejtim ishin të pakët ose jo, sepse me këte numër të vogël studentesh, e me ato note mesatare që vinin, nuk kishin shkruar tekste. Ka vetëm leksione të shkruara. Mjediset janë të mjaftueshme, por, studentët kanë një fond të vogël të teksteve mësimore të lëndëve apo moduleve në shqip në Bibliotekën e UNIKO.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në	Bazuar në rregulloret UNIKO përdor sistemin Pitagora për menaxhimin, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sekretaria mësimore është gjithashtu pjesë e këtij sistemi menaxhimi, Ato disponojnë të gjithë dokumentacionin fizik për këtë qëllim. UNIKO ka marrëveshje me Rrjetin

diplomimin e tyre në programin e studimit.	Akademik Shqiptar (RASH) me anë të së cilës realizon menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave. (Shtojca 1.6. Manual i sistemit elektronik Pitagora, Shtojca 1.6.1. Marrëveshja me rash për sistemin elektronik Pitagora, Shtojca 2.5 Rregullorja e prog te stud TPFF),
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga vizita në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll Arkivës, u konstatua që kjo drejtori administron sistemin e brendshëm të menaxhimit, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Gjithashtu, disponon të gjithë dosjet e personelit akademik, me kohë të plotë, të pjesëshme apo të ftuar, si dhe personelit ndihmës akademik, ku gjenden të gjitha informacionet dhe dokumentet perkatese. Kjo u shikua dhe për dokumentacionin e personelit të Departamentit të Agronomisë, Fakulteti i Bujqësisë. Dosjet i nënshtrohen përditësimeve me dokumenta të tjera në mënyrë të vazhdueshme. (Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 1.4 Rregullorja e drejtorise juridike dhe burimeve njerezore, Shtojca 1.9 Rregullore per mbrojtjen, ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave personale).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Ky menaxhim informacioni dhe dokumentacioni realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll Arkivës. Informacionet për personelin apo studentët e programit të studimit, bëhen duke ruajtur të dhënat zyrtare sipas akteve ligjore ne fuqi. Mbrojtja e të dhënave personale për gjithë sistemet e informacionit më lart respektohen nga dispozitat e ligjit 9887. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit të UNIKO. (Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 1.4 Rregullorja e drejtorise juridike dhe burimeve njerezore, Shtojca 1.9 Rregullore per mbrojtjen, ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave personale).
Kriteri 4. Sistemi i	Referuar RVB marrëveshja midis RASH (Rrjeti Akademik

menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Shqiptar) dhe Uniko parashikon ofrimin e shërbimeve informatike dhe shkëmbimit të informacionit. Të gjitha shërbimet Sofëare që ofron RASH për Uniko, grupohen në një system të posaçëm menaxhimi i specializuar për Uniko (Shtojca 1.6.1. Marrëveshja me rash për sistemin elektronik Pitagora, http://www.unkorce.edu.al/sq/lms).
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi Pitagora i përdorur në programin e studimit profesional dy vjeçar në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, Fakulteti i Bujqësisë, mundëson aksesimin në kohë reale të informacionit në lidhje me studentët, pedagogët, universitetin, lëndet, oraret e mësimi, notat dhe informacione të tjera të universitetit, <u>por nuk garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative apo raportimet individuale</u> . Për secilin përdorues ka një udhëzues të veçantë për përdorimin e modulit përkatës. Sistemi Pitagora siguron akses për çdo student e pedagog dhe është i mbrojtur nga ndërhyrjet e jashtme. (Shtojca 1.6.1. Marrëveshja me rash për sistemin elektronik Pitagora, http://www.unkorce.edu.al/sq/lms , Shtojca 3.16. Model mësimi online).
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Në faqen WEB të UNIKO jepet informacion për lëndët e programit të studimit dhe personelin akademik të angazhuar me to, jepet informacion për aktivitete shkencore si simpoziume apo konferenca etj. UNIKO publikon në faqen zyrtare informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme. Në kete faqe publikohen: Informacionet që lidhen me programin e studimit profesional dy vjeçar në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, informacione për personelin akademik që janë përfshirë në mësimdhënie, aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në nivel departamenti, promovime të Departamentit të Agronomisë, trajnime të ndryshme në fushën e bujqësisë etj. (http://www.unkorce.edu.al/sq/lms).
Konkluzione	<i>UNIKO ka në dispozicion një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit profesional dy vjeçar në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, për aktivitete dhe promovime, apo trajnime.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për këtë cikël të plotë studimi. Cdo vit. UNIKO, në bazë të VKM nr 638 dt 22.07.2015 e ndryshuar, miraton tarifat e shkollimit. Drejtoria Financiare dhe Drejtoria Ekonomike garantojnë financimin dhe mbështetjen e procesit mësimor kërkimor. UNIKO harton dhe raportin financiar vjetor për mbarëvajtjen e programit profesional dy vjeçar në: “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, për ciklin e plotë të studimit, në kuadër të raportit vjetor. Në raportin financiar parashikohen shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen e mjediseve dhe pajisjeve apo reagentëve të nevojshme për mbarëvajtjen programit mësimor të kërrij cikli të plotë studimi. (Shtojca 1.8. Rregullore e drejtorisë financiare (EDE), Shtojca 1.7. Rregullore e drejtorisë ekonomike, Shtojca 1.8.1. Rregullorja financiare).
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	Në takimin me Njësine bazë, u informuam se Departamenti i Agronomisë harton planin financiar për investimet për labororet mesimor, kimikate, reagent, ekspedita, etj., dhe ja parqet Fakultetit të Bujqësisë. UNIKO, në baze të propozimit të fakulteteve harton çdo vit planin e financimit ose projekt buxhetin, i cili miratohet nga senati dhe bordi i administrimit, në të cilin pasqyrohen të gjitha financimet e nevojshme për njësine bazë, me qëllim realizimin e programit të studimit. Janë mbështetur dhe shpenzime për organizimin e konferencave kombëtare apo ndërkombetare, që kanë ndihmuar në ngritjen profesionale të personelit akademik apo dhe studentëve, duke qenë pjesë e planit të financimit. Gjithashtu parashikohet edhe një fond për zhvillimin e praktikave mësimore në funksion të programit të studimit,

financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	për pasurimin e bibliotekës, etj. (Shtojca 4.11. Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit, Shtojca 1.8.1. Rregullorja financiare)
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UNIKO kryen auditim financiar periodik, që realizohet nga Auditi i Brendshëm, për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. UNIKO i nënshtrohet auditimit nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit për të gjitha zërat e financimeve duke u bazuar në dokumentacionin që disponon institucioni. Në raport, pasqyrohen gjetjet dhe jepen konkluzione rreth veprimtarisë së institucionit. (Shtojca 3.15. Praktika e miratimit të buxhetit Uniko, Shtojca 4.11. Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit).
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në kuadër të analizës vjetore të institucionit jepen dhe pasqyrat që tregojnë nivelin e realizimit të buxhetit të vitit paraardhës për çdo njësi bazë. Në analizën vjetore pasqyrohen niveli i realizimit ose mosrealizimit të buxhetit të miratuar duke treguar dhe shkakët për rastin e mosrealizimit. <i>Në fakt nuk ka buxhet të vecantë për programet, pra as për programin e studimit profesional dy vjeçar: "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve"</i> (Shtojca 3.15. Praktika e miratimit të buxhetit Uniko, Shtojca 4.11. Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit).
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	UNIKO garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, duke marrë në konsideratë kërkesat e njësisë bazë, më tej të njësisë kryesore, për një buxhet të mjaftueshëm. Rol në efektivitetin e financimit luan menaxhimi i fondeve duke u përdorur sipas prioriteteve. Raporti i veprimtarisë financiare, diskutohet me organet kolegjiale të Universitetit, si në Rektorat, Bordin e Administrimit dhe në Senatin Akademik. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme të financimit të programeve të studimeve (Shtojca 3.15. Praktika e miratimit të buxhetit Uniko,

	Shtojca 4.11. Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit, Shtojca 1.21. Rregullore e Bordit të Administrimit, Shtojca 1.11. Rregullore e Senatit Akademik)			
Konkluzione	<i>UNIKO disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional kryesisht për Njësitë kryesore dhe ato Bazë.</i> <i>Nuk ka financim për programe, por në financimet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Departamentit të Agronomisë, ka fonde dhe programin e studimit me karakter profesional, si dhe ka financim për aktivitetet shkencore edhe në këto programe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me kriteret e legjislacionit në fuqi, UNIKO ka hartuar një sërë aktesh rregullatore që përcaktojnë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Aktet e brendshme rregullatore kanë parashikime që i referohen edhe ciklit akademik të programit të studimit me karakter profesional "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve". Aktet e brendshme të tilla si Statuti , rregullorja e UNIKO, rregullorja e programit etj, janë të detajura dhe kanë karakter informues në lidhje me kushtet dhe procedurat që mbulojnë të gjithë ciklin akademik dy vjeçar të këtij programi. Në këto akte janë parashikuar në mënyrë mjaft të detajuar aspekte që lidhen me gjithë ciklin akademik si pranimi, kriteret e

	përparimit dhe vlerësimit të dijeve, diplomimit, transferimin të studimeve, etj. Përveç akteve të natyrës rregullatore, informacion i detajuar mund të gjendet edhe faqen web të institucionit apo materialet informative. (Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politika dhe procedurat që zbaton UNIKO mundësojnë ushtrimin e të drejtave dhe garantojnë barazi për studentët në të gjitha programet e studimit që mundëson institucioni si dhe kandidatët për studentë. UNIKO ka përcaktura kritere për pranimin e kandidatëve në përputhje me rregullimet dhe kriteret e përcaktuara të maturës shtetërore. Kriterete e parimit bëhen publike nëpërmjet publikimit në faqen web, duke mundësuar transparencën dhe njohjen e tyre nga të gjithë të interesuarit. Procedurat dhe kriteret që i referohen përparimit akademik, vlerësimit dhe diplomimit mundësojnë përparimin e studentëve bazuar në aftësi dhe meritën. Duke qënë pjesë e përmbajtjes së akteve rregullatore, këto kritere janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe gjithë të interesuarit. (Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, http://www.unkorce.edu.al/sq/node/762)
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	UNIKO çdo vit akademik harton kritere të pranimin të kandidatëve për student në të gjitha programet e ofruara nga institucioni. Kriteret propozohen nga njësiti kryesore të UNIKO në përputhje me specifikën e secilit prej programeve që këto njësi mbulojnë. Në përcaktimin e kriterëve, institucioni respekton kriteret ligjore të pranimin të kandidatëve të përcaktuara në rregullimet ligjore të MASR. Kriteri bazë për pranimin në programin e studimit është përfundimi i një shkollë të mesme, profesionale me profil bujqësor ose të përgjithshme. (Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, http://www.unkorce.edu.al/sq/node/762, Shtojca 3.9. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimin, Shtojca 3.22. Kriteret e pranimin të studentëve).
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të	Bazuar në rregulloret, strategjinë, UNIKO, FB, Departamenti i Agronomisë, Sekretaria si dhe zyra e Karrierës kanë vendosur në dispozicion informacion të plotë në lidhje me procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes, si dhe të përparimit

studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	akademik të studentëve. Në këto procedura përfshihen kalimi nga një vit akademik në tjetrin, etj. UNIKO pranon transferimet e studenteve nga institucione të tjera të arsimit të huaja ose vendase, publike ose jo publike dhe vazhdon më tej me transferimin e studentëve në institucionet e tjera. Departamenti i Agronomisë, ku zhvillohet programi i studimit profesional dy vjeçar në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, ka hartuar dhe ka vënë në dispozicion udhëzues dhe rregullore për studentët e regjistruar në këtë program (Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, http://www.unkorce.edu.al/sq/node/762, Shtojca 3.9. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit, Shtojca 3.22. Kriteret e pranimit të studentëve
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në përputhje me kriteret dhe rregullimet ligjore, UNIKO miraton dhe publikon kriteret për programet e studimeve që ofron. Këto kriteret propozohen dhe miratohen për çdo vit akademik Përveç kriterëve të përcaktura në aktet ligjore dhe udhëzimet e MASR, në përputhje me natyrën e programeve të studimeve si dhe nevojat e tij, institucioni mund të përcaktojë edhe kriteret të veçanta si p.sh ato që i referohen notës mesatare. UNIKO miraton dhe më tej publikon edhe kriteret të veçanta për pranimin e kategorive të veçanta, përfshirë edhe kandidatët me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara. (Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 3.9. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit, Shtojca 3.22. Kriteret e pranimit të studentëve).
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në fillimin e çdo viti akademik, UNIKO, harton procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UNIKO. Studentët mund të gjejnë në faqen elektronike të UNIKO informacione të rëndësishme si fletëpalosje, e cila përmban informacion prezantues rreth UNIKO, programet e studimeve që ofrohen, pranë UNIKO. Sektori i TIK siguron mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të sistemit Pitagora dhe pasqyron çdo informacion për t’i publikuar në internet në portalin e UNIKO. (Shtojca 1.1. Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit

	të TIK, Shtojca 1.20 Rregullore e Bordit të Administrimit).			
Konkluzione	Në përputhje me kriteret e legjislacionit në fuqi, UNIKO ka hartuar një sërë aktesh rregullatore që përcaktojnë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Politika dhe procedurat që zbaton UNIKO mundësojnë ushtrimin e të drejtave dhe garantojnë barazi për studentët e këtij programi studimi, si dhe kandidatët për studentë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Aspektet që lidhen me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve janë subjekt i akteve rregullatore të brendshme. Institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh në nivel institucional, rregullore programesh si dhe rregullore të posaçme që i referohen aspekteve të përparimit akademik deri në diplomim të studentëve. Këto rregullore përmbajnë informacion të detajuar që përfshin të gjithë ciklin akademik, përfshirë edhe kriteret e pranimit në programin e studimit. Një burim i rëndësishëm informacioni janë edhe planet mësimore dhe sylabuset e lëndëve të cilët përmbajnë të gjithë komponentët e nevojshëm informativë si kohëzgjatjen e lëndës, detyrimet që studentët duhet të përmbushin në raport me lëndën, si dhe kriteret e vlerësimit. Studentët marrin informacione të tilla që në javën e parë të vitit akademik nëpërmjet prezantimit nga pedagogët e lëndës, si dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit akademik. I gjithë informacioni i nevojshëm mund të aksesohet edhe në faqen web të institucionit. (Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO, Shtojca 3.22 Kriteret e pranimit të studentëve, Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje	Në këtë program studimi mundësohet transferimi në vitet ndërmjetëse nga institucione të tjera të arsimit të lartë vendase

me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	ose të huaja publike ose private sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimet e MASR si dhe Statutin dhe rregulloret e institucionit. Në përputhje me rregulloren e departamentit dhe Statutin e UNIKO ngrihen komisione të ekuivalentimit të lëndëve me qëllimin e realizimit të të gjitha procedurave të nevojshme të transferimit të studimeve apo njohje të kualifikimeve. Në të njëjtën kohë, në programin e studimit pasqyrohet informacioni për kriteret e pranimit të studentëve, rregullat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve si pjesë e dosjes së programit të studimit. Kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit sanksionohen në rregulloren e UNIKO. (Shtojca 2.5. Rregullorja e programit të studimit “Teknika të Prodhimit të Farave dhe Fidanëve”, http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/udherefyesi2020).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët, në çdo syllabus të lëndëve që marrin gjatë semestrave të studimit në këtë program kanë të përcaktuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve Ndarja e komponentëve të vlerësimit është bërë konform rregullave të përcaktuara nga MASR. Çdo student monitoron studimet e tij nëpërmjet kodit të identifikimi. Ky kod është pjesë e jetës së tij studentore nga momenti i aplikimit deri pas diplomimit. Nëpërmjet këtij instrumenti, çdo student mund të marrë gjithë informacionin e nevojshëm, në lidhje me jetën e tij në Universitet. Ky sistem është lehtësisht i aksesueshëm në distancë dhe nga çdo aparat elektronik smart që posedohet nga studentët (Shtojca 4.15. Manual përdorimi. faqja zyrtare e Uniko, https://www.rash.al/sq/ https://www.unk.pitagora.rash.al/).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	Procedurat e përmbylljes së detyrimeve dhe diplomimit janë objekt rregullimi në aktet e brendshme rregullatore si dhe rregulloren e këtij programi studimi. Procedurat e përmbylljes së detyrimeve dhe diplomimit janë objekt rregullimi në aktet e brendshme rregullatore si dhe rregulloren e këtij programi studimi. Në rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar vetëm procedurat e provimit të formimit, bazuar në programin e provimit të formimit, i cili u vihet në dispozicion studentëve. Studenti përgatitet për provimin e formimit, bazuar në fondin e pyetjeve dhe lëndëve që përfshihen në provim. Studentët njihen me këtë informacion njëkohësisht edhe nëpërmjet sistemit Pitagora, programit të moduleve të programit të studimit, si dhe informacionet që pedagogët

	përcjellin për lëndët ose modulet në fillim të procesit mësimor. Studenti mund të informohet edhe nëpërmjet faqes zyrtare elektronike www.unkorce.edu.al (https://www.unk.pitagora.rash.al/ , www.unkorce.edu.al).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Përpara fillimit të çdo viti akademik, UNIKO merr të gjitha hapat e nevojshëm për të realizuar procesin e informimit në lidhje me programet e studimit që ofron si dhe çdo element tjetër që lidhet me ofertën akademike të këtij institucioni. Informimi i të interesuarve mundësohet nëpërmjet një sërë procedurash të cilat janë të vlefshme edhe për të informuar të interesuarit mbi përmbajtjen dhe ofertën e programit të studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik UNIKO publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Në web studentët e interesuar marrin informacione të rëndësishme, si fletëpalosje të cilat përmbajnë informacione të bollshme rreth UNIKO, programet e studimeve që ofrohen për studentët që zgjedhin të vijnë në studimet e tyre në UNIKO etj. (Shtojca 3.10. Praktika e promovimit dhe informimit të studentëve, Shtojca 3.11. Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit).			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore, e përbërë nga një sërë rregulloresh në nivel institucional si dhe rregullore të posaçme që i referohen aspekteve të përparimit akademik deri në diplomimim e studentëve.</i> <i>Të gjitha procedurat që i referohen ciklit të plotë akademik janë transparente dhe u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet një sërë mekanizmash informues.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,	Studentët marrin informacion nga UNIKO, përsa i përket, strukturës së studimeve, kohëzgjatjes dhe mënyrës së organizimit të programit. Studenti paraqitet fizikisht në javën

organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	e parë të studimit ku, nga personel i departamentit dhe nga sekretaria mësimore merret informimi bazë mbi programin e studimit, syllabuset, punet laboratorike organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Studenti ka në dispozicion sistemin Pitagora si dhe faqen zyrtare të UNIKO (www.unkorce.edu.al).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në dispozicion të studentëve, UNIKO vë informacionon, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët, përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet sistemit Pitagora. Informacioni gjendet i publikuar në faqen web të institucionit, sipas zërave përkatës. Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga sekretaria mësimore. Plani mësimor i programit të studimit është gjatë gjithë vitit akademik i afishuar në stenda të veçanta. Programet e lëndëve gjenden të printuara pranë departamentit, si dhe në formë elektronike. Njëkohësisht informacioni për kurrikulën mësimore, planin mësimor, praktikat profesionale publikohen në web, gjenden në sekretarinë e departamentit të agronomisë, si dhe afishohen në stenda brenda Fakultetit të Bujqësisë dhe pranë sekretarisë së departamentit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me zyrën e këshillimit të karrierës, vërejtëm që studentët informohen mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës, përmes kësaj zyre. Studentët janë përfshirë në aktivitete të shumta informuese për ti njohur ata me kërkesat e punëdhënësve. Studentët përfitojnë nga program i nxitjes së punësimit. Departamenti i agronomisë në fillim të vitit akademik orienton studentët e programit të studimit profesional, dy vjeçar në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, në lidhje me mundësitë e punësimit pasi përfundojnë studimet. Kjo realizohet duke u mbështetur në analizën e tregut të punës dhe përditësimet periodike të tij. (Shtojca 3.6 Raport i përfitimit të marrëveshjeve në funksion të programit të studimit, Shtojca 3.12 Studim tregu pune period ne kuader hapjeje prog std).
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet	Bazuar në dokumentacionin studentët marrin informacion të përditësuar për proceset e mësimi, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. nëpërmjet: -ditëve të orientimit, - prezantimit të lëndëve nga pedagogët në fillim të çdo viti akademik, -sistemit Pitagora për

në funksion të realizimit të tij.	informacione të tjera në lidhje me komponentët e vlerësimit, rezultatet etj, - përmes sekretarive. Studentët, kandidatë për programin e studimit profesional, dy vjeçar në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, marrin informacion për kriteret nëpërmjet promociioneve që organizohen nga institucioni, si dhe në materialet online të vendosura në faqen web të UNIKO. Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) pasi përgatit materialet udhëzuese, ndërmerr fushata të promovimit me anë të takimeve në grup në UNIKO, si dhe pranë institucioneve të përcaktuara nga Drejtoria Rajonale Arsimore e Qarkut Korçë (Shtojca 3.10. Praktika e promovimit dhe informimit të studentëve).			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Praktika profesionale është pjesë e programit mësimor, vlerësuar me 4 kredite (3.33%) që së bashku me lëndët e tjera plotësues (Kategoria D) gjuhë e huaj dhe informatikë zënë 11% të totalit të krediteve. Detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) që përfshin mbrojtjen e tezës së diplomës është 7 kredite ose 5% të krediteve totale. Studentët marrin informacion mbi modalitetet e zhvillimit të praktikës që në fillim të procesit mësimor nga pedagogët përgjegjës. Ata informohen në lidhje me kohëzgjatjen e kryerjes së praktikës, institucionet apo kompanitë ku do të zhvillohet praktika si dhe kriteret e vlerësimit përfundimtar. Për kryerjen e praktikës profesionale institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike dhe private. Institucioni synon maksimalizimin e rezultateve të marrëveshjeve të lidhura, jo vetëm në drejtim të zhvillimit të praktikave profesionale, por edhe të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështetjen e punësimit në përputhje me profilin e programit. (Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale).			
Konkluzione	UNIKO ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Informacioni mundësohet nëpërmjet një sërë burimesh dhe strukturash të dedikura si pedagogët e lëndëve, departamentet, Sekretaria Mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UNIKO disponon dhe administron statistika lidhur me numrin e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi. Institucioni administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Në të dhënat e administruara gjenden informacione jo vetëm mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, por edhe tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit apo transferimet. Të gjitha të dhënat administrohen pranë Sekretarisë Mësimore. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për mbajtjen dhe administrimin e të dhënave të studentëve që nga momenti i regjistrimit. Sekretaria administron të gjithë dokumentacionin që lidhet me studentët përfshirë, transferimet, largimet nga programi etj, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në katër vite akademike rezultoi si më poshtë: Viti akademik 2020-2021 -- 22 studentë; Viti akademik 2021-2022 -- 16 studentë; Viti akademik 2022-2023 -- 21 studentë; Viti akademik 2023-2024 -- 17 studentë; (Shtojca 1.9. Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, Shtojca 3.26. Regjistrimi i studentëve në hyrje, Shtojca 1.5. Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional)
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të	UNIKO menaxhon dhe administron në mënyrë të rregullt të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me studentët që ndjekin këtë program studimi. Të dhënat statistikore të studentëve administrohen pranë Sekretarive Mësimore. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet dhe përpunohet në Drejtorinë e Kurrikulës dhe Vlerësimit

verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucional dhe Qendra e Karrierës dhe Alumni, si dhe kanë të dhënat statistikore të studentëve, që menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga këto dy struktura përkatëse. (Shtojca 1.9. Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, Shtojca 1.5. Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional).
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Kontrolli periodik dhe i përvitshëm është i përcaktuar në aktet rregullore të UNIKO. Informacioni i administruar pranë Sekretarisë Mësimore është lehtësisht i verifikueshëm nga struktura të tjera të kontrollit dhe menaxhimit në nivel Institucioni. Në Fakultet mbahet regjistri i arritjeve akademike dhe diplomave, ku shënohet numri i diplomës dhe lista e notave për të gjithë studentët. Kontrollat e pjesshme janë të përfshira në syllabuset përkatëse dhe ato semestrale janë të njëjshuara si provimet semestrale. Cdo procesverbal i notave të hedhura dërgohet fizikisht në sekretari, i gjeneruar nga sistemi Pitagora, i firmosur nga pedagogu gjenerues, aty ku dhe dokumentohet dhe arshivohet (Shtojca 1.10. Rregullore e sekretarisë mësimore të UK-së, Shtojca 3.8. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë, Shtojca 3.25. Regjistrimi dhe diplomimi i studentëve, Shtojca 3.20. Suplementi i diplomës së programit të studimit)
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Agronomisë si njësia përgjegjëse për mësimdhënien në kuadrin e vlerësimit periodik të programit të studimit analizon periodikisht cilësinë e këtij programi si dhe cilësinë e studentëve. Për çdo vit akademik, departamenti realizon analizën e punës dhe veprimtarisë së tij. Në analizën e punës së departamentit shtrohen edhe problematika të cilësisë së mësimdhënies si dhe cilësisë së procesit mësimor, si shkalla e frekuentimit të procesit mësimor, kalueshmëria etj, duke propozuar edhe masat për përmirësim. NJSBC harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve mbi bazën e të dhënave të sekretarive mësimore, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke i shoqëruar këto raporte me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Sistemi Pitagora shërben për ruajtjen e informacionit të studentëve dhe ku mund të aksesohet në kohë reale. (Shtojca 1.10. Rregullore e sekretarisë mësimore të UK-së, Shtojca 3.8. Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë, Shtojca 3.25. Regjistrimi dhe diplomimi i studentëve,

	Shtojca 4.4. Tabela e të dhënave të regjistrimit dhe ecurisë së studentëve në hyrje dhe dalje).			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht në mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave të hollësishme, në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në politikat që harton dhe zbaton, UNIKO synon një qasje që e vendos studentin në qendër të procesit. Rregullorja e UNIKO parashikon të drejtën e studentëve për të marrë pjesë me përfaqësuesit e tyre në proceset vendimmarrëse të institucionit në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi si dhe ato të Statutit. UNIKO përfshin angazhimin në diskutime të Studentët që janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Po kështu studentët kanë përfaqësimin e tyre edhe në Këshillin e Etikës me një student përfaqësues si dhe kanë përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit. (Shtojca 1.17. Rregullorja e Këshillit Studentor, Shtojca 1.20. Rregullore e Këshillit të Etikës)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në struktura të ndryshme është garantuar nga UNIKO bazuar në një sërë dokumnetash e evidencash. Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik UNIKO. Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në Komisionin Institucional Zgjedhor si dhe janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit. Prezenca aktive e studentëve në vendimmarrje është imponuese dhe vërejtjet e sugjerimet e tyre gjithmonë merren parasysh nga organet përkatëse.

	(Shtojca 1.17. Rregullorja e Këshillit Studentor, Shtojca 1.20. Rregullore e Këshillit të Etikës)		
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në rregulloret e institucionit, studentëve u garantohej përfshirja në procesin e hartimit, rishikimit si dhe përmirësimit të programeve të studimit. Përfshirja e studentëve në institucion bëhet nëpërmjet pyetësorëve që ata plotësojnë për lëndët dhe performancën e pedagogëve të tyre. Në fakt ka vetëm një pyetësor për institucionin dhe nuk ka patur pyetësor për programet ose pedagogët, në këtë program studimi Departamenti i agronomisë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit dhe reflekton sugjerimet e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj (Shtojca 3.13. Model pyetësori studentor)		
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në një sërë aktesh të brendshme UNIKO ka parashikime të detajuara në lidhje me procedurat e ankimit të procesit të vlerësimit të dijeve. Nëpërmjet të drejtës së ankimit, studentëve u jepet mundësia të shprehin mendimin e tyre mbi ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si dhe rishikimit të rezultatit të vlerësimit. Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 5 sezone: sezoni i dimrit (shkurt, mars); sezoni i verës (qershor, korrik); sezoni i vjeshtës (shtator), sezoni plotësues dhe sezoni para provimit të diplomës me tre provime. Nga vizita e GVJ në institucion dhe takimi me studentët, u konfirmua se mundësia e ankimit është reale, u mundësohet të gjithë studentëve dhe është pasuar nga reflektimi i institucionit, njësisë apo pedagogut në rishikimin dhe ndryshimin e rezultatit të vlerësimit.. (Shtojca 1.2. Rregullore e Universitetit “Fan S.Noli” Korçë)		
Konkluzione	<i>UNIKO përfshin studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Aktet rregullatore të institucionit garantojnë që përfshirja e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim mbi procesin akademik si dhe atë të vlerësimit të dijeve, të jetë reale dhe me rezultate konkrete.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në kuadrin e kompetencave që aktet rregullatore të brendshme u japin strukturave organizative, një nga komponentët më të rëndësishëm mbetet mbështetja, informimi dhe shërbimi ndaj studenteve. Një tërësi strukturash si departamenti, dekanati etj, në kuadrin e kompetencave të tyre, mbështesin dhe orientojnë studentët, si dhe manaxhojnë problematikat në aspekte që lidhen me procesin mësimor. Në shërbim të studentëve vihen në dispozicion Sektori i Informacionit dhe Promocionit, Sektori i TIK-ut, dhe Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, Sektori i Projekteve dhe Kërkimit. Institucioni vë në dispozicion të studentit rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar më parë. (Shtojca 1.2. Rregullore e Universitetit “Fan S.Noli” Korçë), Shtojca 4.16. Organograma e Uniko)
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Brenda institucionit janë ngritur dhe funksionojnë një sërë strukturash që së bashku mundësojnë një sistem efikas të informimit, këshillimit dhe mbështetjes së studentëve për aspekte që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Departamenti si njësi bazë, ka një rol mjaft të rëndësishëm për mbajtjen e kontakteve me studentët dhe mbështetjen e tyre në procesin mësimor. Nëpërmjet Sistemit Pitagora studentët informohen për rezultatet e arritura në procesin e vlerësimit në provime. Pranë Sekretarisë Mësimore, studentët mund të marrin informacion në lidhje me aspekte të procesit mësimor gjatë gjithë vitit akademik. Njokohësisht, mund të kërkojnë realizimin e shërbimeve të tilla si: marrjen e dokumentacionit, vërtetimeve etj.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe	Nëpërmjet Zyrës së Alumni dhe Këshillimit të Karrierës, UNIKO u ofron studentëve shërbimin e Këshillimit të Karrierës. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë ketyre strukturave. Zyra për këshillim dhe karrierë, si dhe pedagogët në departament orientojnë studentët në:

periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	- Identifikimin e lidhjeve mes diplomës dhe mundësive për karrierë. - Evidentimin e strategjive në mënyrën e të kërkuarit të punës - Identifikimin e shprehive dhe aftësive - Njihen edhe me praktikat profesionale me kompani të njohura, sipas programit dhe rregullores së tij. Qendra e Karrierës dhe Alumni u krijua në 2012. Ajo zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli”. QKA funksionin si një zyrë që ofron shërbime për maturantët, studentët dhe alumni. Shtojca 2.2. Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Bujqësisë, Shtojca 2.3 Rregullore e njësise baze Departamenti i Agronomise, Shtojca 2.4 Plani strategjik per zhvillimin e programit_njesise. Shtojca 2.10 mareveshje bashkepun ne mbeshkje te prakt profesn)
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Qendra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI kryen kërkime për të evidentuar ecurinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi. Puna e saj mbështetet në tre shtylla kryesore: - Informim (këshillim karriere për maturantët); - Trajnim (këshillim për studentët aktuale në UK); - Ndërmjetësim me punëdhënësin (mundësi punësimi për studentët Alumni); Lidhjet janë të mbajtura nga anëtarët e departamentit me studentët nëpërmjet komunikimeve me anë adresave të email, rrjeteve sociale etj. Nevojat e sektorit të bujqësisë për teknikë të diplomuar në “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve” janë bërë të njohura nëpërmjet studimeve për tregun e punës në bujqësi. Është studiuar trendi i prodhimit dhe shitjes së farave dhe fidanëve të produkteve bujqësore, nëpërmjet informacionit të marrë nga prodhuesit dhe tregtarët dhe anketimeve të kryera në mënyrë të vazhdueshme. QKA nuk ka një database në ndjekjen e studentëve që janë diplomuar, kjo sipas saj për shkak të ndërrimit të numrit të telefonave ose adresave të e-maileve, ose largimit nga Shqipëria. <u>GVJ mendon se duhet të punohet më shumë për gjurmimin e studentëve pas përfundimit të studimeve nga zyrat dhe sektorët përkatës.</u>

	Shtojca 4.6. Tabela përmbledhëse për punësimin e studentëve të programit të studimit Shtojca 3.12. Studim tregu pune periodik/ në kuadër hapjeje programi studimi, Shtojca 3.5. Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikant https://docs.google.com/forms/d/e/1			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UNIKO ka struktura që merren me informimin e studentëve, këshillimin e tyre përgjatë viteve që janë pjesë e këtij Institucioni, por duhet të punohet më shumë për gjurmimin e studentëve pas përfundimit të studimeve nga zyrat dhe sektorët përkatës.</i> <i>Ndërsa pritja, orientimi, këshillimi i studentëve, menaxhimi i ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme, janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve" është unik dhe nuk ka programe të ngjashme për krahasim, duke përmbushur kërkesat për specializim në këtë fushë;
2. Një aspekt i rëndësishëm i programit “Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”, me karakter profesional, vlerësohet të jetë efektshmëria e tij në orientimin e studentëve, për t'u integruar në tregun e punës dhe për të ofruar një eksperiencë praktike, që i përgatit ata për sfidat dhe mundësitë e punës në fushën e teknologjisë bujqesore, duke i bërë studimet më të efektshme dhe konkurruese në tregun e punës;

3. Programi synon të ofrojë njohuri dhe të zhvillojë aftësi profesionale në fushën e bujqësisë. Kjo arrihet përmes një stafi akademik të kualifikuar dhe praktikave profesionale në ambiente të ndryshme, për të përgatitur teknikë të specializuar;
4. Stafi ndihmës akademik dhe drejtuesit e praktikave gjithashtu, vlerësohet që ndihmojnë në aftësimin e studentëve në qasjet direkte si edhe në vendet e punës që i presin ata pas mbarimit të studimeve;
5. Programi sygjeron përdorimin e teknologjive dhe pajisjeve më të fundit, në mënyrë që studentët të mund të kenë përvojë më të pasur në punësim dhe një përparim më të shpejtë në karrierën e tyre profesionale;
6. Programi ka objektiva të qartë për formimin profesional të studentëve, duke përshtatur dijet dhe aftësitë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Praktikë laboratorike dhe në terren janë pjesë integrale për të zhvilluar aftësi praktike të studentëve;
7. Fakulteti Bujqësisë ofron një infrastrukturë funksionale laboratorike dhe praktike, në realizimin me efektivitet të këtij programi studimi. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të ndryshme, janë faktor për të realizuar praktikë profesionale dhe aftësimin teknologjik dhe praktik të studentëve. Përfshirja në mobilitete e stafit, përmes marrëveshjeve të arritura me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Shqipërisë, favorizojnë këtë program studimi;

b. Pika të dobta:

1. Literatura që i referohet studentëve mund të përmirësohet duke e bërë më të plotë, specifike dhe të aksesueshme në gjuhën shqipe, për t'iu përshtatur më mirë nivelit të tyre. Gjithashtu, mund të konsiderohet zhvillimi i një sistemi dixhital për menaxhimin e librave. *(Standarti IV.3, Kriteret 1 dhe 5)*
2. Sistemi aktual i menaxhimit ka mundësi për përmirësim, veçanërisht në garantimin e monitorimit në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, si dhe në raportimet individuale. *(Standarti IV.4, Kriteri 5)*
3. Mund të ketë vend për përmirësim në ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve nga zyrat përkatëse të institucionit. *(Standarti V.6, Kriteri 4)*

Rekomandime:

1. Të rishihen raportet përfundimtare me mirë nga stafi akademik, meqë numri i studentëve është më i vogël, krahasuar me numrin e personelit akademik
2. Pyetësorët për studentët, të bëhen në mënyrë periodike dhe të rregullt.

3. Sigurimi i materialeve didaktike bazë dhe shtesë për t'u përdorur nga stafi akademik i programit të studimit, si edhe nga studentët, duke përfshirë librat, artikujt shkencorë dhe faqet e internetit;
4. Pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në seminare dhe konferenca të fushës për zgjerimin e njohurive dhe në përmirësimin e aftësive praktike bujqesore;
5. Të ketë një sistem më të mirëorganizuar të gjurmimit të studentëve që kanë mbaruar këtë program studimi, për të patur dhe një qasje më të mirë për orientimin dhe këshillimin e studentëve;

Conclusions of the Evaluation of the 2-Year Professional Study Program "Techniques for Seed and Seedling Production,"

a. Strengths and Affirmations:

1. The "Techniques for Seed and Seedling Production" program is unique, with no similar programs for comparison, fulfilling the requirements for specialization in this field;
2. An important aspect of the professional program "Techniques for Seed and Seedling Production" is its effectiveness in guiding students towards integration into the labor market and offering practical experience that prepares them for the challenges and opportunities in the field of agricultural technology, making the studies more effective and competitive in the job market;
3. The program aims to provide knowledge and develop professional skills in agriculture, achieved through a qualified academic staff and professional practices in various environments, preparing specialized technicians;
4. The support academic staff and practice supervisors are also valued for helping students develop hands-on approaches and preparing them for the jobs that await them after graduation;
5. The program suggests the use of the latest technologies and equipment to provide students with better employment experiences and faster advancement in their professional careers;
6. The program has clear objectives for the professional formation of students, aligning knowledge and skills with labor market demands. Laboratory and field practices are integral to developing students' practical skills;



7. The Faculty of Agriculture offers a functional laboratory and practical infrastructure for the effective implementation of this study program. Cooperation agreements with various institutions are a factor in realisation of professional practices and the technological and practical training of students. The inclusion of staff in mobility programs, through agreements with higher education institutions inside and outside Albania, favors this study program;

b. Weaknesses:

1. The literature that refers to students could be improved by making it more comprehensive, specific, and accessible in the Albanian language, to better match their level. Additionally, developing a digital system for book management could be considered; *(Standard IV.3, Criteria 1 and 5)*
2. The current management system can be improved, particularly in ensuring real-time monitoring of academic and administrative activities, as well as individual reporting; *(Standard IV.4, Criterion 5)*
3. There may be possibilities for improvement in the follow-up of students after completing their studies by the relevant offices of the institution; *(Standard V.6, Criterion 4)*

Recommendations:

1. The final reports should be reviewed more thoroughly by the academic staff, given the smaller number of students compared to the number of academic personnel;
2. Questionnaires for students should be conducted periodically and regularly;
3. Ensure the availability of basic and supplementary didactic materials for use by the academic staff and students, including books, scientific articles, and websites;
4. Increase participation of academic staff and students in field-specific seminars and conferences to expand knowledge and improve practical agricultural skills;
5. Establish a better-organized system for tracking students who have completed this study program to improve guidance and counseling for current students;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

